



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 259 Akti

Nr. 337 Vendimi
Tiranë, më 18.1.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesve ndërkombëtarë znj. Marie Tuma dhe z. Tonci Petkovic, në Tiranë, në datat 26 shkurt 2020, ora 10:00, 15 shtator 2020, ora 12:00 dhe 14 janar 2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike¹ çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Bib Ndreca**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

¹ Seancat dëgjimore të datave 26 shkurt 2020 dhe 14 janar 2021 u zhvilluan në prani të vëzhguesit ndërkombëtar znj. Marie Tuma, ndërsa seanca dëgjimore e datës 15 shtator 2020 u zhvillua në prani të vëzhguesit ndërkombëtar z. Tonci Petkovic.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancat dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES / SEANCAT DËGJIMORE

- 1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në nenin 179/b paragrafi 5 të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar) dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit, z. Bib Ndreca, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- 3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), më 15.1.2019 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Etleda Çiftja dhe Pamela Qirko. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere, znj. Pamela Qirko.
- 4.** Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.1.2019, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Xhensila Pine, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin.
- 5.** Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për z. Ndreca nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
- 6.** Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
- 7.** Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
- 8.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjisllacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- 9.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e në vijim “DSIK”) dhe Këshilli Lartë Gjyqësor (këtu e në vijim “KLGJ”).

10. ILDKPKI-ja, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë, ka dërguar një raport² të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë dhe;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

11. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim ka dërguar raportin³ e mbajtur për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese, të kryera në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Bib Ndreca⁴.

12. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport⁵ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraprakisht vlerësoi se ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe në datën 5.2.2020 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në datën 6.2.2020 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit e zhvilluar kryesisht nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 7.2.2020, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve, provave të reja dhe kërkesave lidhur me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, në datën 20.2.2020.

² Akti i kontrollit nr.*** prot., datë 8.1.2018.

³ Raporti nr. *** prot, datë 30.10.2017.

⁴ Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së me nr. *** datë 7.7.2020.

⁵ Raporti për analizimin e aftësisë profesionale me nr. *** prot., datë 12.2.2019.

16. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve, provave të vëna në dispozicion, si edhe kërkesave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në datën 24.2.2020 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁶.

17. Në datën 26.2.2020, ora 10:00 u zhvillua seanca e parë dëgjimore me subjekti e rivlerësimit. Gjatë kësaj seance, z. Bib Ndreca, krahas kërkesës për riçeljen e hetimit administrativ (kërkesë e shqyrtuar dhe e mospranuar më parë nga trupi gjykues), kërkoi dhënien e kohës shtesë për t'u shprehur në lidhje me analizën financiare. Pasi u tërhoq në dhomë këshillimi, me qëllim garantimin e së drejtës për mbrojtje efektive dhe në respektim të procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues vendosi⁷ të shtyjë seancën dëgjimore me qëllim dhënien e kohës së nevojshme subjektit të rivlerësimit për t'u shprehur në lidhje me analizën e detajuar financiare të vënë në dispozicion nga Komisioni në datën 24.2.2020. Seanca e radhës u caktua të zhvillohej në datën 3.3.2020, në orën 15:00.

18. Në datën 2.3.2020 subjekti depozitoi kërkesë për shtyrjen e seancës dëgjimore, për shkak se ndodhej në pamundësi objektive për t'u paraqitur në seancë, për arsye shëndetësore. Pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar bashkëlidhur saj⁸, trupi gjykues vendosi⁹ pranimin e kërkesës së subjektit – shtyrjen e seancës dëgjimore të datës 3.3.2020. Seanca e radhës u caktua të zhvillohej në datën 12.3.2020, në orën 15:00.

19. Në datën 8.3.2020 subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesë për riçeljen e hetimit administrativ, ribërjen e ekspertimit kontabël dhe marrjen/administrimin e provave të reja shkresore për të kundërshtuar rezultatet e hetimit paraprak. Pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, trupi gjykues vendosi: (i) mospranimin e kërkesës për riçeljen e hetimit administrativ dhe për ribërjen e ekspertimit kontabël me ekspert të pavarur; (ii) pranimin e kërkesës së subjektit për administrimin dhe shqyrtimin e provave të depozituara me *e-mail*-in e datës 8.3.2020, pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

20. Në vijim, në datën 11.3.2020 subjekti i rivlerësimit depozitoi një kërkesë të re për shtyrjen e seancës dëgjimore, të parashikuar për t'u zhvilluar në datën 12.3.2020, me shkakun e pamundësisë objektive për t'u paraqitur në seancë. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, vendosi¹⁰ shtyrjen e seancës dhe caktimin e zhvillimit të saj në datën 25.3.2020, ora 11:00.

21. Në datën 24.3.2020 Komisioni njoftoi se seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Bib Ndreca, e përcaktuar për t'u mbajtur më 25.3.2020, ora 11:00, nuk do të zhvillohej për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme në vend, të shkaktuar nga pandemia e virusit COVID - 19 dhe se seanca e radhës do të njoftohej sërish në faqen zyrtare.

22. Në datën 13.5.2020, pasi shqyrtoi kërkesën e depozituar nga subjekti nëpërmjet postës elektronike, trupi gjykues vendosi¹¹ riçeljen e hetimit administrativ dhe vijimin e hetimit për të tria kriteret e vlerësimit.

23. Në datën 22.7.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua për përfundimin e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të vlerësimit: të kontrollit të figurës dhe të kriterit të vlerësimit profesional, iu dërguan rezultatet e hetimit dhe u vu në dijeni për të drejtën e njohjes me dosjen, marrjen e një kopjeje të saj, si edhe të paraqiste prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit, brenda datës 27.7.2020.

⁶ Vendimi nr. 4, datë 24.2.2020, me anë të të cilit u vendos të ftohet subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 26.2.2020.

⁷ Vendimi i ndërmjetëm nr. 5, datë 26.2.2020.

⁸ Raporti mjekësor për paafësi të përkohshme për punë nr. *** regjistri, për periudhën 2.3.2020 – 7.3.2020.

⁹ Vendimi i ndërmjetëm nr. 6, datë 2.3.2020.

¹⁰ Vendim i komunikuar subjektit me *e-mail*-in e datës 11.3.2020.

¹¹ Vendimi i ndërmjetëm nr. 8, datë 13.5.2020.

24. Në datën 23.7.2020, subjekti i rivlerësimi njoftoi¹² se për shkaqe objektive (arsye shëndetësore) ishte në pamundësi për t'u paraqitur në afatin e kërkuar për t'u njohur me dosjen dhe për të dhënë shpjegime/depozituar provat përkatëse lidhur me hetimin administrativ. Pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar bashkëlidhur saj¹³, trupi gjykues vendosi¹⁴ shtyrjen e afatit të caktuar për njohjen me dosjen deri në datën 7.8.2020.

25. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve, provave të reja dhe kërkesave lidhur me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, në datën 19.8.2020.

26. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve, provave të vëna në dispozicion si edhe kërkesave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në datën 10.9.2020 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore¹⁵.

27. Në seancën dëgjimore të datës 15.9.2020 u relatuan rezultatet e hetimit administrativ. Gjatë kësaj seance subjekti i rivlerësimit, z. Bib Ndreca, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

28. Në vijim, në datën 17.9.2020, Komisioni vendosi¹⁶ riçeljen e hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e disa veprimeve verifikuese hetimore shtesë, sipas vlerësimit të bërë nga anëtarët e trupit gjykues.

29. Në datën 8.10.2020 trupi gjykues vendosi¹⁷ mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, duke i komunikuar vënien në dispozicion të materialeve, dokumentacionit të administruar rishtazi nga Komisioni, pas riçeljes së hetimit administrativ, si edhe për të sjellë shpjegimet/komente të mundshme lidhur me to. Në datën 13.10.2020 përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit u njoh me materialet e reja të dosjes dhe mori kopje fizike të tyre.

30. Në datën 17.11.2020 Komisioni vendosi¹⁸ për kalimin në seancë dëgjimore të subjektit të rivlerësimit, z. Bib Ndreca, seancë e përcaktuar për t'u zhvilluar në datën 25.11.2020.

31. Në datën 20.11.2020 subjekti depozitoi kërkesë me objekt "shtyrjen e seancës dëgjimore", për shkak të pamundësisë shëndetësore. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi këtë kërkesë dhe verifikoi raportet mjekësore të dërguara bashkëlidhur saj, vlerësoi se ekzistonin shkaqe të arsyeshme për shtyrjen e seancës dëgjimore dhe vendosi¹⁹ pranimin e kërkesës së subjektit, duke përcaktuar se seanca e radhës do të zhvillohej në një datë të pacaktuar, në muajin janar të vitit 2021.

32. Në vijim, duke qenë se subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen, mori një kopje të saj, si dhe dërgoi shpjegimet e tij në rrugë zyrtare, në datën 8.1.2020, trupi gjykues vendosi²⁰ të ftojë z. Bib Ndreca në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim që të paraqiste komentet dhe deklaratat e tij përfundimtare në lidhje me vlerësimin e provave, rezultatet e hetimit dhe rezultatin e mundshëm të procedurës së rivlerësimit.

¹² Nëpërmjet postës elektronike (me e-mail).

¹³ Raport mjekësor për paaftësi të përkohshme për punë, për një afat 11 ditë, duke filluar nga data 20.7.2020 – 31.7.2020.

¹⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 9, datë 27.7.2020.

¹⁵ Vendimi i ndërmjetëm nr. 4, datë 10.9.2020 – me anë të të cilit u vendos të ftohet subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore në datë 15.9.2020.

¹⁶ Vendimi i ndërmjetëm nr. 12, datë 17.9.2020.

¹⁷ Vendimi i ndërmjetëm nr. 13, datë 8.10.2020.

¹⁸ Vendimi i ndërmjetëm nr. 14, datë 17.11.2020.

¹⁹ Vendimi i ndërmjetëm nr. 15, datë 23.11.2020.

²⁰ Vendimi i ndërmjetëm nr. 16, datë 8.1.2020, me anë të të cilit u vendos të ftohet subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore në datën 14.1.2020.

33. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

34. Z. Bib Ndreca ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

34.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

35. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

35.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

35.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

35.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

35.4. Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

35.5. Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017²¹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

36. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për

²¹ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

37. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

37.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së z. Bib Ndreca.

37.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqëndruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2) të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

38. Pasuri e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 1,830.6 m², e ndodhur në Fushë - Mamurras, e cila vjen nga pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi, blerë në vitin 2004, në vlerën 500,000 lekë. Pjesa takuese 100%. Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri mban nr. ***, volum ***, faqe ***, e cila rrjedh nga pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi me nr. ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***.

38.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (1) të ardhurat e vëllezërve nga emigracioni; si dhe (2) të ardhurat e realizuara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar si person fizik i vëllait të tij.

38.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në deklaratën përpara fillimit të detyrës²² subjekti ka deklaruar pasurinë në bashkëpronësi të llojit arë+truall+ndërtesë, me nr. pasurie ***, me sipërfaqe totale 5,600 m², nga e cila 3,100 m² truall dhe 871 m² ndërtesë, pasuri kjo e ndodhur në Fushë - Mamurras, Kurbin, e blerë në datën 2.3.2004, për vlerën 500,000 lekë dhe se zotëron 1/3 e kësaj pasurie, në vlerën 166,666 lekë. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat e përfituara në emigracion përgjatë viteve 1993 - 1999, nga vëllezërit e tij Sh., dhe P.N., periudhë për të cilën deklaroi se ka qenë në të njëjtin trung familjar me ta. Ndërsa, në DPV/2011 subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “tokë arë”, me nr. ***, me sipërfaqe 1,830.6 m², të ndodhur në Fushë - Mamurras, e cila vjen nga pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi, e deklaruar përpara fillimit të detyrës.

²² Dorëzuar në ILDKPKI në datën 6.2.2009.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

38.3. ASHK-ja, ZVRPP-ja Kurbin²³konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria e llojit “arë”, me sipërfaqe 1,830.6 m², regjistruar me nr. pasurie ***, volum ***, faqe ***, zonë kadastrale ***.

38.4. Sa më sipër, duket se subjekti nuk ka deklaruar saktë numrin e kësaj pasurie, pasi pasuria me nr. *** (referuar në deklaratën “Vetting”) është pasuri e regjistruar në emër të vëllait të subjektit pas pjestimit të pasurisë me nr. ***, pasuri e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 1,883.6 m².

38.5. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit dha shpjegimet e tij lidhur me pasaktësinë e konstatuar në deklarin e numrit të pasurisë, duke parashtruar se ka ardhur si pasojë e pasaktësisë në plotësimin e dokumentacionit nga vetë zyrtarët e ZVRPP-së Kurbin. Subjekti ka shpjeguar se në deklarin e kësaj pasurie i është referuar certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar më 20.6.2011, dokument i depozituar si provë nga subjekti.

38.6. Nga analiza e shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vëren se pasaktësia në deklarin ka ardhur si pasojë e pasaktësisë në plotësimin e dokumentacionit nga vetë ZVRPP-ja Kurbin. Gjithsesi, konfirmohet se të dhënat e tjera të vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri përkojnë me të dhënat e dërguara nga kjo zyrë regjistrimi.

38.7. Në vijim, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje për këtë pasuri, konstatohet se në datën 2.3.2004, subjekti i rivlerësimit dhe vëllzërit e tij, z. Sh.N., dhe z. P.N., kanë blerë²⁴ nga shtetasit R.Xh., dhe V.Xh., pasurinë me nr. ***, e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 5,600 m², të ndodhur në Fushë - Mamurras, kundrejt vlerës 500,000 lekë. Sipas kontratës së shitblerjes rezulton se kjo shumë është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

38.8. Ndërsa, referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme duket se në datën 2.3.2004 fillimisht ajo është regjistruar vetëm në emër të vëllait të subjektit, z. Sh.N., dhe se, në datën 2.2.2006 është regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të dy vëllezërve të tij, z. Sh.N., dhe z. P.N.

Historiku i regjistrimit/zhvillimit të kësaj pasurie

39. Rezulton se: (i) referuar kontratës së shitblerjes të datës 2.3.2004, por edhe dokumentacionit të regjistrimit fillestar të saj, kjo pasuri është regjistruar në emrin e subjektit të rivlerësimit dhe vëllezërve të tij si pasuri e llojit “arë”, me nr. pasurie ***, me sipërfaqe 5,600 m²; (ii) pas investimeve të kryera mbi këtë pasuri nga totali i sipërfaqes prej 5,600 m², sipërfaqja prej 1,550 m² është regjistruar si truall, nga i cili 395 m² janë regjistruar si sipërfaqe ndërtese dhe në vijim të investimeve nga totali i sipërfaqes prej 5,600 m², sipërfaqja prej 3,100 m² është regjistruar si truall, nga i cili 871 m² janë regjistruar si sipërfaqe ndërtese; (iii) në datën 29.6.2011 pas pjesëtimit të kësaj pasurie, në emrin e subjektit të rivlerësimit është regjistruar pasuria e llojit “tokë arë” me nr. ***, me sipërfaqe 1,830.6 m²; dhe (v) në datën 30.3.2017, subjekti ka shkëmbyer me vëllain e tij, z. P.N., pasurinë e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 1,830.6 m², të ndodhur në Fushë – Mamurras, me nr. pasurie *** me pasurinë e llojit “tokë arë”, me nr. pasurie ***, me sipërfaqe 1,221.3 m².

²³ Shkresa nr. ***prot., datë 2.9.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot.

²⁴ Kontratë shitblerje me nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.03.2004.

39.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Kurbin për këtë pasuri rezulton se:

(i) në datën 23.9.2005 KRRT-ja e Bashkisë Mamurras ka nxjerrë në favor të z. Sh.N., lejen e ndërtimit²⁵ për objektin “Kompleksi i rritjes së derrave”, me sipërfaqe 395 m² mbi pasurinë me nr. ***. Gjithashtu, konstatohet se në datën 8.2.2006 Bashkia Mamurras ka dhënë lejen e shfrytëzimit²⁶ për këtë objekt. Në dokumentacionin e sipërcituar, si investitor i këtij objekti paraqitet z. Sh.N., ndërsa si zbatues i punimeve (subjekt ndërtues) paraqitet shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ***. Sipas aktit të kolaudimit punimet kanë filluar më 1.10.2005 dhe kanë mbaruar më 30.1.2006 dhe sipas situacioneve të likuiduara vlera faktike e punimeve është 7,985,000 lekë.

(ii) në datën 2.7.2007, KRRT-ja e Bashkisë Mamurras ka nxjerrë në favor të z. Sh.N., lejen e ndërtimit²⁷ për objektin “Stallë materniteti derrash”, objekt i cili është ndërtuar mbi pasurinë objekt hetimi (pasuria nr. ***). Si subjekt ndërtues paraqitet shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ***. Paraprakisht, Komisioni nuk dispononte të dhëna për investitorin, shoqërinë ndërtuese, sipërfaqen dhe koston e ndërtimit, si dhe periudhën e përfundimit të këtij objekti.

39.2. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti depozitoi dokumentacion ligjor provues për ndërtimin e këtij objekti si vijon: (i) leje ndërtimi nr. ***, datë 2.7.2007, lëshuar nga KRRT-ja Bashkia Mamurras; (ii) leje shfrytëzimi nr. *** prot., datë 5.11.2008; (iii) procesverbal kolaudimi objekti; (iv) kontratë e datës 10.7.2007 lidhur mes investitorit z. Sh.N., dhe sipërmarrësit “****” sh.p.k.; (v) faturë tatimore e datës 26.12.2007; (vi) leje mjedisore nr. *** prot., datë 31.5.2007; dhe (vii) projekti teknik dhe dokumentacion tjetër shoqërues lidhur me këtë objekt.

39.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar për këtë objekt rezulton se sipërfaqja e sheshit të ndërtimit është 1,500 m², sipërfaqja e ndërtimit është 476 m² dhe vlera e tij është 3,293,376 lekë. Gjithashtu, duket se ndërtimi i këtij objekti ka përfunduar në datën 7.9.2007.

39.4. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, të lëshuar nga ZVRPP-ja Kurbin në datën 17.11.2008, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit dhe dy vëllezërit e tij, z. Sh.N., dhe z. P. N., figurojnë të jenë bashkëpronarë të pasurisë me nr. ***, të llojit “arë+truall+ndërtese”, me sipërfaqe totale 5,600 m², prej së cilës sipërfaqe trualli 3,100 m² dhe sipërfaqe ndërtese 871 m², të ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, në Fushë - Mamurras, Kurbin.

39.5. Në datën 29.6.2011 është bërë pjesëtimi²⁸ i kësaj pasurie dhe, sipas kontratës, subjekti i rivlerësimit duket se ka përfituar pasurinë e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 1,886.6 m², por faktikisht në ZVRPP-në Kurbin në emrin e tij është regjistruar pasuria e llojit “tokë arë”, me nr. ***, me sipërfaqe 1,830.6 m².

39.6. Pra, konstatohet se në momentin e dorëzimit të deklaratës fillestare të pasurisë (dorëzuar në ILDKPKI në datën 6.2.2009), subjekti i rivlerësimit figuron bashkëpronar i pasurisë me sipërfaqe totale 5,600 m², prej së cilës sipërfaqe trualli 3,100 m² dhe sipërfaqe ndërtese 871 m², pasuri e investuar (pas blerjes së saj në gjendje “tokë arë” në vitin 2004) në vlerën 11,278,346 lekë, nga e cila vlera 7,985,000 lekë si investim për objektin “kompleks i rritjes së derrave” dhe vlera 3,293,376 lekë si investim për objektin “stallë materniteti derrash”.

39.7. Rezulton se me kontratën e shkëmbimit²⁹ të datës 30.3.2017 subjekti i rivlerësimit i ka dhënë vëllait të tij, z. P.N., pasurinë e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 1,830.6 m², të ndodhur në

²⁵ Vendim i KRRT-së nr. ***, datë 23.9.2005.

²⁶ Leje shfrytëzimi me nr. *** prot., datë 8.2.2006.

²⁷ Leje ndërtimi me vendim të KRRT-së me nr. ***, datë 2.7.2007.

²⁸ Kontrata e pjesëtimit të pasurisë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.6.2011.

²⁹ Kontrata me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.3.2017.

Fushë-Mamurras (me nr. pasurie ***) dhe në këmbim ka marrë pasurinë e llojit “tokë arë” me sipërfaqe 1,221.3 m² (me nr. pasurie ***)³⁰.

39.8. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie - për gjendjen e saj në momentin e deklarimit.

40. Pasuri e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 1,221.3 m², e ndodhur në Fushë - Mamurras, e cila vjen nga pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi, blerë në vitin 2004 në vlerën 500,000 lekë. Pjesa takuese 100%. Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri mban nr. ***, volum ***, faqe ***, e cila rrjedh nga pjesëtimi i pasurive në bashkëpronësi me nr. *** dhe nr. ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***.

40.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (1) të ardhurat e vëllezërve nga emigracioni; si dhe (2) të ardhurat e realizuara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar si person fizik i vëllait të tij.

40.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në deklaratën përpara fillimit të detyrës³¹ subjekti ka deklaruar pasurinë në bashkëpronësi të llojit “arë”, me nr. pasurie ***, me sipërfaqe totale 3,664 m², të ndodhur në Fushë - Mamurras, Kurbin, e blerë në datën 2.3.2004, për vlerën 500,000 lekë dhe se zotëron 1/3 e kësaj pasurie, në vlerën 166,666 lekë. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat e përfituara në emigracion nga vëllezërit e tij Sh., dhe P.N., përgjatë viteve 1993 - 1999, periudhë për të cilën deklaroi se ka qenë në të njëjtin trung familjar me ta. Ndërsa, në DPV/2011 subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “tokë arë”, me nr. ***, me sipërfaqe 1221.3 m², të ndodhur në Fushë-Mamurras, e cila vjen nga pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi të deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

40.3. ASHK-ja, ZVRPP-ja Kurbin³² konfirmon se në emrin e subjektit të rivlerësimit është regjistruar pasuria e llojit “arë”, me sipërfaqe 1,221.3 m², me nr. pasurie ***, volum ***, faqe ***, zonë kadastrale ***.

40.4. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Kurbin konstatohet se në datën 2.3.2004, subjekti i rivlerësimit dhe vëllezërit e tij, z. Sh.N., dhe z. P.N., kanë blerë³³ nga shtetasit R.Xh., dhe V.Xh., pasurinë me nr. ***, të llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 5,664 m², të ndodhur në Fushë-Mamurras, kundrejt vlerës 500,000 lekë. Nga kontrata e shitblerjes rezulton se kjo shumë është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

40.5. Rezulton se në vitin 2006 nga pasuria me nr. ***, e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 5664 m², subjekti i rivlerësimit dhe vëllezërit e tij i kanë shitur shtetasit Gj.M., sipërfaqen prej 2,000 m², për vlerën 10,000 lekë, pasuri kjo e regjistruar me nr. ***, ndërsa pjesa tjetër e kësaj pasurie, e mbetur në bashkëpronësi me vëllezërit, me sipërfaqe prej 3,664 m², është regjistruar me nr. ***, me vlerë 323,443 lekë.

40.6. Duket se, në deklarimin e vlerës së kësaj pasurie si në deklarimin fillestar, ashtu dhe në deklaratën “Vetting”, subjekti i referohet vlerës së blerjes së pasurisë me nr. ***. Siç u përmend edhe më sipër, një pjesë e kësaj pasurie është shitur dhe në momentin e deklarimit përpara fillimit të detyrës subjekti ka disponuar në bashkëpronësi me vëllezërit e tij pasurinë e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 3,664 m², me vlerë të regjistruar në ZVRPP-në Kurbin 323,443 lekë

³⁰ Deklaruar në DPV/2017.

³¹ Dorëzuar në ILDKPKI në datën 6.2.2009.

³² Shkresa nr. ***prot., datë 2.9.2019, protokolluar në KPK me nr. *** prot., 4.9.2019.

³³ Kontrata e shitblerjes së tokës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.3.2004.

(vlerë e llogaritur nga çmimi për metër katror, i paguar nga subjekti dhe vëllezërit e tij për blerjen e pasurisë nr. *** prej 5664 m², pasuri nga e cila ka rrjedhur).

40.7. Në datën 29.6.2011, është bërë pjesëtimi³⁴ i kësaj pasurie në bashkëpronësi dhe me kontratë pjesëtimi subjekti ka përfituar “tokë arë”, me sipërfaqe 1,221 m², e regjistruar me nr. *** pasurie.

40.8. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie për gjendjen e saj në momentin e deklarimit.

41. Pasuri e llojit “arë”, me sipërfaqe 2,733.33 m², ndodhur në Fushë - Mamurras, e cila vjen nga pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi, blerë në vitin 2005, në vlerën 400,000 lekë. Pjesa takuese 100%. Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri mban nr. ***, volum ***, faqe ***, dhe rrjedh nga pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi me nr. ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***.

41.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (1) të ardhurat e vëllezërve nga emigracioni; si dhe (2) të ardhurat e realizuara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar si person fizik i vëllait të tij.

41.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në deklaratën përpara fillimit të detyrës³⁵, subjekti ka deklaruar pasurinë në bashkëpronësi të llojit “arë+truall+mulli bloje”, e regjistruar me nr. *** pasurie, me sipërfaqe totale 8,200 m², të ndodhur në Fushë Mamurras, Kurbin, blerë në datën 15.3.2005 dhe se zotëron 1/3 e kësaj pasurie (në vlerën 133,333.3 lekë). Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat nga aktiviteti tregtar i vëllezërve së bashku gjatë periudhës 2003 – 2007. Ndërsa, në DPV/2011, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “tokë arë”, me nr. ***, me sipërfaqe 2,733.3 m², të ndodhur në Fushë-Mamurras, e cila vjen nga pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi të deklaruar në deklaratën para fillimi të detyrës.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

41.3. ASHK-ja, ZVRPP-ja Kurbin³⁶ konfirmon se në emrin e subjektit të rivlerësimit ka qenë e regjistruar pasuria e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 2,733.3 m², regjistruar me nr. *** pasurie, volum ***, faqe ***, zonë kadastrale ***.

Historiku i regjistrimit/zhvillimit të kësaj pasurie

41.4. Rezulton se: (i) sipas kontratës së shitblerjes të datës 15.3.2005, por edhe dokumentacionit të regjistrimit fillestar të saj, kjo pasuri është regjistruar në emrin e subjektit të rivlerësimit dhe të vëllezërve të tij si pasuri e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 8,200 m²; (ii) pas investimit të kryer mbi këtë pasuri, nga totali i sipërfaqes prej 8,200 m², sipërfaqja prej 1,440 m² është regjistruar si truall dhe sipërfaqja prej 396 m² është regjistruar si ndërtesë; (iii) në datën 29.6.2011, pas pjesëtimi të kësaj pasurie në emrin e subjektit të rivlerësimit është regjistruar pasuria e llojit “tokë arë”, me nr. ***, me sipërfaqe 2,733.33 m²; (iv) në datën 30.3.2017, pasuria me nr. ***, ndahet në: (a) pasurinë nr. ***, me sipërfaqe 2,371 m²; (b) pasurinë nr. ***, me sipërfaqe 112 m², dhe (c) pasurinë nr. ***, sipërfaqe 250 m²; dhe (v) në datën 5.4.2017, subjekti i rivlerësimit i ka shitur vëllezërve të tij Sh.N., dhe P.N., pasurinë nr. *** dhe pasurinë nr. ***, në vlerën 300,000 lekë.

41.5. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Kurbin rezulton se më 15.3.2005 subjekti i rivlerësimit dhe vëllezërit e tij z. Sh.N., dhe z. P.N., kanë blerë³⁷ nga

³⁴ Kontrata e pjesëtimi të pasurisë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.6.2011.

³⁵ Dorëzuar në ILDKPKI në datën 6.2.2009.

³⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 2.9.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., 4.9.2019.

³⁷ Kontrata shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.3.2005.

shtetasit Gj. R., dhe M.R., pasurinë me nr. *** të llojit “tokë arë” me sipërfaqje 8,200 m², të ndodhur në Fushë-Mamurras, kundrejt vlerës 400,000 lekë.

41.6. Gjithashtu, konstatohet se në datën 23.9.2005 KRRT-ja e Bashkisë Mamurras ka nxjerrë në favor të z. Sh.N., lejen e ndërtimit³⁸ për objektin “Mulli bloje gruri”, me sipërfaqe 396 m² mbi pasurinë me nr. ***. Bashkia Mamurras në datën 10.2.2006, ka dhënë lejen e shfrytëzimit³⁹ për këtë objekt. Nga dokumentacioni i sipërcituar rezulton se investitor i këtij objekti paraqitet z. Sh.N., ndërsa si zbatues i punimeve (subjekt ndërtues) paraqitet shoqëria “***” sh.p.k. Sipas aktit të kolaudimit për këtë objekt punimet kanë filluar më 2.10.2005 dhe kanë përfunduar më 26.1.2006 dhe, sipas situacioneve të likuiduara vlera faktike e punimeve është 9,800,000 lekë.

41.7. Konfirmohet nga certifikata për vërtetim pronësie e datës 20.2.2006, e lëshuar nga ZVRPP-ja Kurbin, se subjekti i rivlerësimit së bashku me vëllezërit e tij kanë qenë bashkëpronarë të pasurisë me nr. ***, e llojit “arë+truall+mulli bloje”, me sipërfaqe totale 8,200 m², nga e cila sipërfaqe trualli 1,440 m² dhe sipërfaqe ndërtese 396 m².

41.8. Në datën 29.6.2011 është bërë pjesëtimi⁴⁰ i kësaj pasurie në bashkëpronësi, nga e cila subjekti ka përfutur një arë, me sipërfaqe 2,733.33 m², e regjistruar me nr. *** pasurie.

41.9. Pra, rezulton se në momentin e dorëzimit të deklaratës fillestare të pasurisë (dorëzuar në ILDKPKI në datën 6.2.2009) subjekti i rivlerësimit figuron bashkëpronar i pasurisë me sipërfaqe totale 8200 m², prej së cilës sipërfaqe trualli 1,444 m² dhe sipërfaqe ndërtese 396 m², pasuri e investuar pas blerjes së saj në gjendje “tokë arë” në vitin 2005, në vlerën 9,800,000 lekë.

42. Gjithashtu, konstatohet se në datën 30.3.2017 pasuria në pronësi të subjektit të rivlerësimit (pas pjesëtitimit), arë me nr. *** pasurie ndahet në: (a) pasurinë me nr. ***, me sipërfaqe 2,371 m², (b) pasurinë me nr. ***, me sipërfaqe 112 m²; dhe (b) pasurinë me nr. ***, sipërfaqe 250 m².

43. Në vijim, nëpërmjet kontratës⁴¹ së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme të datës 5.4.2017, subjekti i rivlerësimit i ka shitur vëllezërve të tij, Sh.N., dhe P.N., pasuritë me nr. *** dhe nr. ***, në vlerën totale 300,000 lekë⁴².

44. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie për gjendjen e saj në momentin e deklarimit.

Analiza e burimeve financiare që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të llojit “tokë arë” dhe investimeve të kryera mbi to, ku subjekti i rivlerësimit shfaqet si bashkëpronar deri në vitin 2011.

45. Sipas deklaratës përpara fillimit të detyrës dhe deklaratës “Vetting” konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kontribut në blerjen e pasurive të llojit “tokë arë” në bashkëpronësi me vëllezërit e tij, të blera në vitet 2004 dhe 2005, me çmim total në vlerën 1,400,000 lekë. Si burim krijimi të këtyre pasurive ka deklaruar të ardhurat e vëllezërve nga emigracioni dhe nga ushtrimi i aktivitetit tregtar si person fizik nga vëllai i tij, z. Sh.N.

45.1. Në këtë këndvështrim, duket se shuma 466,467 lekë, e cila i përgjigjet vlerës për 1/3 pjesë takuese të subjektit të rivlerësimit mbi këto pasuri, përfaqëson shumë të dhuruar në favor të

³⁸ Vendim i KRRT-së nr. ***, datë 23.9.2005.

³⁹ Leje shfrytëzimi me nr. *** prot., datë 10.2.2006.

⁴⁰ Kontrata e pjesëtitimit të pasurisë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.6.2011.

⁴¹ Kontrata me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.4.2017.

⁴² Deklaruar në DPV/2017.

subjektit të rivlerësimit nga vëllezërit e tij, materializuar në pjesë takuese në tokë bujqësore të llojit “arë”.

45.2. Në bazë të pikës 14 të nenit 3, si edhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, z. Sh.N., dhe z. P.N., bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast bazuar në parimin e proporcionalitetit, të shumës 466,467 lekë, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e pasurive të llojit “tokë arë”, ku subjekti i rivlerësimit figuron si bashkëpronar.

45.3. Komisioni i kërkoi subjektit të deklaronte burimin e të ardhurave të përfituara nga vëllezërit e tij në emigracion, si edhe të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor për to⁴³. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se **vëllai i tij Sh. N., ka shkuar në Greqi në muajin mars të vitit 1991 dhe deri në dhjetor të vitit 1995 ka punuar në Kymina-Selanik, tek shtetasi grek me emrin Ch.T., dhe se për dy vitet e para është paguar me shumën prej 250,000 dhrami në muaj, ndërsa në vitet e tjera është paguar në shumën prej 350,000 dhrami në muaj. Në vijim ka shpjeguar se vëllai i tij Sh.N., nga janari 1996 – shtator 1997 ka ndryshuar pronar, duke u punësuar tek shtetasi grek Ch. N., (si agregate bujqësor) dhe është paguar me 350,000 dhrami në muaj si pagë bazë dhe 750,000 dhrami në muaj në sezonet e punës (mbjellje – korrje). Më tej, deklaroi se për periudhën shtator të vitit 1997 deri në dhjetor të vitit 1998, ai është ripunësuar tek shtetasi grek Ch.T., duke u paguar me shumën 400,000 dhrami në muaj. Referuar pohimeve të vëllait të tij, shuma e përfitur nga emigracioni në shtetin grek ka qenë në total rreth 6,000,000 dhrami, të cilat i ka sjellë në Shqipëri në vite të ndryshme. Vëllai i tij, z. Sh. N., i ka pohuar se gjatë kohës që ai ka qenë emigrant ekonomik në shtetin grek nuk ka qenë i regjistruar pranë autoriteteve, pasi sipas tij regjistrimet e emigrantëve për të marrë leje qëndrimi në shtetin grek kanë filluar në vitin 1998. Gjithashtu subjekti deklaroi se, **vëllai i tij z. P.N., i ka shpjeguar se, ka punuar në Greqi si emigrant ekonomik nga muaji dhjetor 1992 deri në fund të vitit 2011, i punësuar nga shtetasi grek Ch.T., duke u paguar për dy vitet e para me pagë 250,000 dhrami në muaj, për vitet e tjera të punësimit me pagë 350,000 dhrami në muaj dhe se, në tre sezona të punësimit ka marrë si bonus nga 700,000 dhrami, si i punësuar në makineri bujqësore. Në referim të deklarimeve të vëllait të tij, z. P.N., subjekti sqaroi se ai ka aplikuar për t’u pajisur me leje qëndrimi në vitin 1998 dhe që nga ky vit ka qëndruar me leje qëndrimi në këtë shtet. Sipas tij, të ardhurat totale të përfituara nga emigracioni kanë qenë në shumën prej 22,600,000 dhrami.****

45.4. Për sa i përket dokumentacionit justifikues ligjor për krijimin e këtyre të ardhurave, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se vëllezërit e tij kanë deklaruar se nuk disponojnë të dhëna dokumentare për pagim taksash në shtetin grek dhe se ato i kanë sjellë cash dhe jo nëpërmjet institucioneve financiare të ardhurat e përfituara nga puna e kryer si emigrant ekonomik në shtetin grek.

45.5. Për të konfirmuar deklaratimet e tij subjekti ka depozituar si dokumentacion provues: (i) deklaratë noteriale⁴⁴ e datës 27.3.2019, të shtetasit grek Ch.T.; (ii) deklaratë noteriale⁴⁵ e datës 7.10.2019, nga vëllai i tij, z. P.N.; (iii) deklaratë noteriale⁴⁶ e datës 7.10.2019, nga vëllai i tij, z. P.N.; dhe (iv) dokumentacion shkresor sipas së cilit konfirmohet se vëllai i tij, z. P.N., ka aplikuar për leje qëndrimi në shtetin grek.

45.6. Sa më sipër, duket se, pretendimet e subjektit për shumat e të ardhurave të përfituara nga vëllezërit e tij si emigrantë ekonomikë në shtetin grek, janë kryesisht të karakterit deklarativ.

⁴³ Pyetësori nr. 2.

⁴⁴ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.3.2019.

⁴⁵ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2019.

⁴⁶ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2019.

45.7. Me dërgimin e prapësimeve pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se u qëndron shpjegimeve të dhëna më parë në përgjigje të pyetësorëve, të dërguar nga Komisioni, duke parashtruar në vijim se emigracionin ekonomik në Greqi e kanë pranuar institucionet kombëtare greke dhe ato ndërkombëtare, ku pasqyrohet se në vitet 1991 – 1998 emigrantët ekonomikë kanë punuar pa leje qëndrimi, të paregjistruar në organet shtetërore dhe se vetëm në gjysmën e dytë të vitit 1998 kanë filluar lejet e para të qëndrimit për punë dhe regjistrimet e tyre.

45.8. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka depozituar si provë të re raportin “Mbi emigracionin në Greqi, 1990 – 2003” (në gjuhë të huaj, anglisht), të parashtruar nga M. B.,– E., në Forumin e mbajtur në Gjenevë të Zvicrës në vitin 2004, aksesuar nga subjekti në faqen zyrtare të UNECE. Gjithashtu, subjekti ka depozituar 3 mandatpagesa në gjuhën greke (të depozituara edhe më parë si dokumentacion shoqëruar në përgjigje të pyetësorëve të dërguara nga Komisioni), të përkthyer nga përkthyes ligjorë të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë, sipas të cilave pretendon disa pagesa të kryera në favor të njërit prej vëllezërve të tij për punë të kryera në shtetin grek.

Të ardhurat e përfituara nga vëllai i subjektit, z. Sh.N., nga ushtrimi i aktivitetit tregtar si person fizik

46. Sipas të dhënave të përfituara nga QKB-ja⁴⁷ konstatohet se z. Sh.N., ka qenë regjistruar si person fizik me vendimin nr. ***, datë 31.1.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

46.1. Me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting” (shtojca 2), ndër të tjera, subjekti ka depozituar në ILDKPKI⁴⁸: (i) vendimin e gjykatës të datës 31.1.2003, për regjistrimin e personit fizik, Sh.N.; (ii) kopje të certifikatës së regjistrimit në organin tatimor; dhe (iii) disa formularë të llogaritjes së taksës vendore të biznesit të vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për periudhën 2003, 2004 dhe 2005, për subjektin “****”, person fizik, me NIPT ***, me aktivitet “prodhim mielli”.

46.2. Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë⁴⁹ informon se subjekti “****” person fizik, i pajisur me Nipt ***, ka qenë i regjistruar si biznes i vogël dhe, si i tillë, tatimet dhe taksat janë paguar në Njësinë Vendore Laç. Ky subjekt rezulton se nuk ka detyrime tatimore të papaguara. Bashkëlidhur ka dërguar fotokopje të formularëve të llogaritjes së taksës vendore për biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për këtë subjekt, për vitet 2003, 2004 dhe 2005.

46.3. Referuar formularëve të depozitura nga subjekti i rivlerësimit si edhe të dërguara nga DRT-ja Lezhë për subjektin “****”, person fizik, referohen të dhënat si vijon: (i) për vitin 2003 qarkullimi i realizuar në shumën 500,000 lekë; (ii) për vitin 2004 qarkullimi i realizuar në shumën prej 1,000,000 lekë; dhe (iii) për vitin 2005 qarkullimi i realizuar në shumën 1,000,000 lekë.

46.4. Siç përmendet më sipër, pasuritë e llojit “tokë arë” në bashkëpronësi me vëllezërit janë blerë në total në shumën 1,400,000 lekë dhe pasuria e fundit është blerë në datën 15.3.2005. Për këtë periudhë është pasqyruar me dokumentacion justifikues ligjor vetëm qarkullimi i realizuar nga ushtrimi i aktivitetit si person fizik nga vëllai i subjektit, për vitet 2003 – 2004, në total, në vlerën 1,500,000 lekë. Kjo shumë përfaqëson qarkullimin bruto të realizuar nga ky aktivitet, pa konsideruar gjithë shpenzimet e mundshme operationale dhe fikse.

Investimet e kryera në pasuritë objekt hetimi

⁴⁷ Ky vendim është i bashkëlidhur në ekstraktin historik të regjistrit tregtar të shoqërisë “****” sh.p.k.

⁴⁸ Aneks *** në dosjen e ILDKPKI.

⁴⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 2.8.2019.

47. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje si edhe vetëdeklarimet e bëra nga subjekti për pasuritë e llojit “tokë arë”, për kohën që ato kanë qenë të pandara në bashkëpronësi me vëllezërit, konstatohet se: (i) në vitet 2005 - 2006 mbi këto pasuri janë ndërtuar dy objekte (kompleksi i rritjes së derrave dhe mulli bloje derrash) me vlerë totale 17,785,000 lekë; si edhe (ii) në vitin 2007 është ndërtuar objekti “stallë materniteti derrash”, me vlerë totale 3,293,376 lekë.

47.1. Rezulton se deri në momentin e pjesëtimit të pasurive të llojit “tokë arë + truall + ndërtesë” në vitin 2011, pasuri në bashkëpronësi me vëllezërit, këto pasuri, përfshirë dhe ndërtesat e investuara kanë qenë regjistruar në ZVRPP-në Kurbin edhe në emrin e subjektit si bashkëpronar.

47.2. Referuar paragrafit të dytë të nenit 199 të Kodit Civil, i cili parashikon se “*pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta*”, investimi i kryer prej subjektit të rivlerësimit në këto pasuri u llogarit në 1/3 pjesë të totalit të investimit të kryer, nga ku duket se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për të mundësuar kryerjen e këtij investimi.

47.3. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet e tij përfundimtare lidhur me këto pasuri, investimet e kryera, si edhe mbi ligjshmërinë e burimeve të krijimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

48. Subjekti i rivlerësimit u ka qëndruar deklarimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, duke parashtruar se ai nuk ka asnjë kontribut financiar në krijimin këtyre pasurive dhe se, si burim krijimi ka referuar të ardhurat e vëllezërve nga emigracioni dhe nga aktiviteti tregtar.

48.1. Lidhur me mospërputhjet e konstatuara në deklarimet e burimit të krijimit të pasurive të llojit “tokë arë” (mes deklarimit përpara fillimit të detyrës dhe deklaratës “Vetting”) subjekti ka shpjeguar se, duke konsideruar faktin që ai ka qenë student në momentin e blerjes së këtyre pasurive dhe se nuk ka pasur kontribut në krijimin e tyre, në deklaratën “Vetting” është deklaruar saktësisht burimi i të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtyre pasurive në bashkëpronësi (në total në vlerën 1,400,000 lekë), sipas asaj që i kanë deklaruar në mënyrë të hollësishme vëllezërit e tij.

48.2. Ndërsa, për mosdeklarimin e vlerës së investimit të kryer mbi këto pasuri në deklaratën para fillimit të detyrës, pjesën takuese të investimit, si edhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e tij, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se ai nuk ka pasur asnjë kontribut në kryerjen e investimeve mbi këto pasuri, por vetëm ka pasur tokë arë, e cila, duke qenë se akoma nuk ishte pjesëtuar, investimi i kryer mbi këtë pasuri nga vëllai/vëllezërit e tij në certifikatën e pronësisë është shënuar në bashkëpronësi dhe se në momentin që do pjesëtohej, ai do kishte në pronësi vetëm tokë bujqësore dhe jo truall apo ndërtesë.

48.3. Subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri ishte vënë si hipotekë në bankë përpara fillimit të detyrës në vitin 2009 dhe për këtë arsye nuk mund të pjesëtohej pa një marrëveshje me bankën.

48.4. Deklarimi i bërë në vitin 2009 (në deklaratën përpara fillimit të detyrës) është bërë duke iu referuar shënimit në certifikatën e pronësisë, por asnjëherë nuk ka pasur dhe as nuk ka asnjë metër katror truall apo ndërtesë në Fushë-Mamurras, Kurbin, para apo pas fillimit të detyrës, por vetëm tokë bujqësore. Vetëm pasi banka e lejoi pjesëtimin e pasurive, të cilat ishin vënë në hipotekë⁵⁰ në datën 28.6.2011, një ditë më pas, në datën 29.6.2011 u pjesëtuan pasuritë, nga

⁵⁰ Ka depozituar si provë deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.6.2011.

ku, siç rezulton edhe në kontratën e pjesëtimit të pasurive, ai ka përfituar pjesën takuese të tokës bujqësore (tokë arë) dhe nuk ka përfituar pasuri të llojit truall apo ndërtesë. Si burim krijimi për investimet e kryera subjekti ka referuar të ardhurat nga emigracioni të vëllezërve, të ardhurat nga aktiviteti tregtar i tyre, si edhe kreditë e marra nga shoqëria “****” sh.p.k.

Analiza përfundimtare e kryer nga Komisioni për këto pasuri/vlerësimi i provave

49. Për pjesën takuese të subjektit të rivlerësimit nga blerja e pasurive të llojit “tokë arë” në vitet 2004 – 2005, në bashkëpronësi me vëllezërit, dhe burimin e krijimit të saj

49.1. Nga analiza e provave të administruara në dosje, si edhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vëren se:

- a) subjekti në vazhdimësi, në deklaratën përpara fillimit të detyrës, në deklaratën “Vetting” dhe gjatë hetimit administrativ nuk ka deklaruar kontribut për krijimin e tyre;
- b) këto pasuri janë krijuar në kohën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë student në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër (konfirmuar fakti me dokumentacion ligjor provues), pra, para fillimit të detyrës;
- c) subjekti në deklaratën “Vetting” ka deklaruar burimin e krijimit të këtyre pasurive bazuar në deklaratimet e vëllezërve të tij, në përputhje me deklaratimet e vazhdueshme të tij se këto pasuri janë blerë me të ardhurat e vëllezërve;
- d) ka të dhëna dhe *indicie* të besueshme se vëllezërit e tij kanë qenë emigrantë ekonomikë në shtetin grek për një periudhë të gjatë kohe; të ardhurat nga emigracioni deklaruar si një nga burimet e krijimit të këtyre pasurive;
- e) konstatohet se qarkullimi i realizuar nga subjekti tregtar “****”, person fizik, për vitet 2003 – 2004 është në total në vlerën 1,500,000 lekë, deklaruar të ardhurat nga aktiviteti tregtar si një nga burimet e krijimit të këtyre pasurive.

49.2. Si konkluzion, duke vlerësuar të gjitha rrethanat dhe faktet e mësipërme, si edhe duke marrë në konsideratë vlerën e pjesës takuese të subjektit mbi këto pasuri (vlera 466,467 lekë), bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, trupi gjykues vlerëson se nuk mund të ngrihen dyshime për krijimin e këtyre pasurive të llojit “arë”, të regjistruara fillimisht në bashkëpronësi me vëllezërit e subjektit, pjesëtuar në vitin 2011.

Lidhur me investimet e kryera mbi këto pasuri

50. Komisioni konstatoi se mbi pasuritë e llojit “tokë bujqësore” në bashkëpronësi të subjektit me vëllezërit e tij, në vitet 2005, 2006, 2007 janë kryer investime për ndërtimin e tri objekteve, me vlerë totale në shumën 21,07,8376 lekë.

50.1. Nga analiza e provave të administruara në dosje, si edhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këto investime të kryera, Komisioni vëren se:

- a) në deklaratën përpara fillimit të detyrës subjekti ka deklaruar të dhënat e këtyre pasurive sipas certifikatës së pronësisë, por në deklarimin e tij ka referuar vetëm kontratat e blerjes së pasurive të llojit “tokë arë” dhe vlerën e blerjes së tyre dhe nuk ka referuar të dhëna për vlerë investimesh mbi këto pasuri.
- b) konfirmohet me dokumentacion ligjor provues fakti i deklaruar nga subjekti se këto pasuri ishin vënë në hipotekë në emër të bankës, për kredi të marra nga shoqëria “****” sh.p.k.;
- c) konfirmohet me dokumentacion ligjor provues fakti i deklaruar nga subjekti se, pasi banka lejoi pjesëtimin e këtyre pasurive, një ditë më pas është nënshkruar kontrata e

pjesëtimit, ku faktikisht subjekti i rivlerësimit ka përfituar pjesë takuese vetëm për pasuri të llojit “tokë arë”;

- d) ndërtimi i këtyre objekteve është kryer gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit ka qenë duke ndjekur studimet në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër dhe në vijim në Shkollën e Magjistraturës, pra, janë pasuri të investuara dhe të krijuara përpara fillimit të detyrës;
- e) bazuar në dokumentacionin tekniko - ligjor për investimet e kryera në ndërtimin e këtyre objekteve rezulton se si investitor shfaqet vetëm z. Sh.N., si individ.

50.2. Nga vlerësimi në harmoni i shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe atyre të dërguara pas rezultateve të hetimit me deklaratimet e bëra prej tij ndër vite në ILDKPKI, si edhe bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje lidhur me këto pasuri, provohet fakti se si investitor i këtyre objekteve është z. Sh.N., si individ, dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë kontribut për krijimin e tyre dhe nuk ka pretenduar dhe as pretendon pjesë takuese të këtyre pasurive, të cilat, që prej vitit 2011 janë regjistruar si pasuri në emër të vëllezërve të tij.

50.3. Si konkluzion, duke vlerësuar të gjitha rrethanat dhe faktet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë nuk janë pasuri të investuara nga subjekti i rivlerësimit apo të regjistruara në emrin e tij, për më tepër, duke qenë se ato janë krijuar përpara fillimit të detyrës, kryerja e këtyre investimeve dhe analizimi i burimeve financiare të tyre, nuk mund të jenë pjesë dhe nuk mund të ndikojnë në procesin e rivlerësimit dhe as në vendimmarrjen përfundimtare për këtë subjekt.

51. Pasuri e llojit “arë+truall+ndërtesë”, me sipërfaqe totale 2490 m², nga e cila 300 m² truall dhe 41 m² ndërtesë, e ndodhur në ***, Mirditë. Subjekti ka deklaruar se zotëron 1/6 pjesë takuese të kësaj pasurie, përfituar si anëtar i familjes bujqësore në bazë të ligjit “Për tokën”.

51.1. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës⁵¹ subjekti ka deklaruar se zotëron 1/7 pjesë takuese të kësaj pasurie, por ZVRPP-ja Mirditë⁵² nuk konfirmon regjistrimin e saj.

51.2. Me dorëzimin e deklaratës “Vetting” për këtë pasuri subjekti ka depozituar si dokumentacion provues⁵³: (i) vërtetimin e Komunës Fan, datë 19.10.2014; (ii) certifikatë familjare për gjendjen e trungut familjar në datën 1.8.1991 (përbërë nga 6 anëtarë); dhe (iii) vërtetim nga ZVRPP-ja Mirditë, datë 21.10.2016.

51.3. Sipas vërtetimit të Komunës Fan konstatohet se z. P.N.P., nga fshati Petoq ka përfituar nga ligji “Për tokën” sipërfaqen prej 2490 m² tokë, me nr. ***, ***, *** pasurie dhe nr. *** pasurie, në zonën kadastrale ***, ndërsa sipas vërtetimit të ZVRPP-së Mirditë, në emër të tij figuron e regjistruar në fshatin ***, pasuria e ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, me sipërfaqe totale 2490 m², prej të cilës 300 m² truall dhe 41 m² ndërtesë.

51.4. Nga analizimi i këtij dokumentacioni duket se pasuria e mësipërme është e regjistruar në emër të shtetasit P.N.P., ndërkohë që babai i subjektit mban gjeneralitet (emër/atësi/mbiemër) **P.N.N.**

51.5. Komisioni i kërkoi subjektit të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor për regjistrimin e kësaj pasurie në emrin e babait të tij në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore, si edhe dokumentacion justifikues ligjor për origjinën e krijimit të pasurisë së llojit “ndërtesë” me sipërfaqe 41 m², pasuri për të cilat ai ka vetëdeklaruar se zotëron 1/6 pjesë.

⁵¹ Dorëzuar në ILDKPKI në datën 6.2.2009.

⁵² Shkresa me nr. *** prot., datë 22.10.2019.

⁵³ Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së.

51.6. Në prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit shpjegoi se gabimi në shënimin e mbiemrit të babait ka ardhur pasi në atë kohë dokumenti plotësohej në bazë të emrit me të cilin njihej apo thirrej shtetasi dhe jo në bazë të dokumentit të identifikimit.

51.7. Për të provuar deklaramet e tij subjekti i rivlerësimit depozitoi si provë të re vërtetimin e datës 11.2.2020, lëshuar nga Njësia Administrative Fan, fshati ***, sipas të cilit konfirmohet se z. P.N.P., i biri i N., dhe i M., i datëlindjes 18.3.1940, lindur në Xhuxhë, Rrethi Mirditë, ish-banor i fshtatit Petoq, Njësia Administrative Fan, Bashkia Mirditë, është i njëjti person me z. P.N.N., i datëlindjes 18.3.1940, lindur në Xhuxhë, Rrethi Mirditë, ish-banor i fshtatit Petoq, Njësia Administrative Fan, i cili ka banuar në fshatin Petoq deri në vitin 1997.

51.8. Në vijim subjekti ka sqaruar se në bazë të ligjit “Për tokën”, si edhe VKM-së nr. 255/1991, babait të tij të ndjerë i është dhënë tokë bujqësore si kryefamiljar dhe si rrjedhim, edhe ai vetë si pjesë e familjes bujqësore (referuar certifikatës familjare në të njëjtin trung familjar me babain) ishte përfitues.

51.9. Ndërsa, lidhur me ndërtesën, subjekti ka shpjeguar se babai i tij në gjallëri i ka shpjeguar se ajo banesë ka filluar të ndërtohet në vitin 1920 nga gjyshi N.P.N., dhe ka përfunduar në vitin 1964. Gjithashtu ka sqaruar se që nga viti 1997 në këtë objekt nuk ka banuar njeri dhe se aktualisht është tërësisht i amortizuar.

52. Për të mbështetur deklaramet e tij subjekti ka depozituar foto të këtij objekti, ku duket se në hyrjen kryesore të tij (derën) është shkruar e gdhendur në gur “N.P.”⁵⁴ dhe gjithashtu shënimi “V. 1964”, që përkon me vitin e përfundimit të kësaj banese, sipas vetëdeklarimit të subjektit.

52.1. Referuar certifikatës për gjendjen familjare datë 1.8.1991 konstatohet se z. P.N., (si kryefamiljar), ka qenë në certifikatë familjare së bashku me gjashtë anëtarë të tjerë të familjes, ku pjesë përbërëse është dhe subjekti i rivlerësimit, z. Bib Ndreca.

52.2. Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, parashikon kalimin në pronësi të tokës bujqësore te anëtarët e kooperativës bujqësore.

52.3. Sipas pikës 5 të VKM-së nr. 230, datë 22.7.1991, “Për krijimin e komisioneve të tokës”, Komisioni, përcakton në bashkëpunim me fshatarët, vendin dhe sipërfaqen e tokës së secilit dhe përpilon në dy kopje aktin e marrjes së tokës nga çdo familje, me firmë të kryetarit të Komisionit, dhe të specialistit të autorizuar nga komisioni i rrethit, si dhe të kryefamiljarit që merr tokën.

52.4. Sipas pikës 4 të udhëzimit nr. 2, datë 2.8.1991, “Për funksionimin e komisioneve të tokës të rretheve të fshatrave”, komisioni i tokës në fshat, në bazë të të dhënave për tokën dhe përbërjes familjare, cakton sipërfaqen e tokës në metër katror për frymë dhe sipërfaqen e tokës për çdo familje, sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

52.5. Ndërsa, sipas pikës 2 të VKM-së nr. 255, datë 2.8.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, në të gjitha rastet, toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991.

52.6. Nga dispozitat e mësipërme si edhe pas vlerësimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të depozituar prej tij për këtë pasuri, Komisioni çmon se subjekti ka deklaruar saktë pjesën takuese të pasurisë së llojit “tokë bujqësore” (përfutuar me ligj) dhe se nuk ka dyshime për krijimin e pasurisë së llojit “objekt banimi”, me sipërfaqe 41 m².

⁵⁴ Subjekti deklaroi se kështu njihej gjyshi i tij.

53. Pasuria e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 84.6 m², ndodhur në kompleksin “****”, rruga “****”, Tiranë, me vlerë 40,000 euro, përfituar sipas kontratës për kalim të drejtash⁵⁵, të datës 29.5.2012. Subjekti deklaron se zotëron 100% pjesë të kësaj pasurie.

53.1. Si burim krijimi ka deklaruar: (1) shumën 5,000 euro si kursime personale ndër vite; (2) shumën 35,000 euro pjesë e huas së marrë nga të tretët; dhe (3) kredinë bankare të marrë në vitin 2012.

53.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: sipas deklaratës periodike vjetore të vitit 2012 (dorëzuar nga në datë 4.3.2013 në ILDKPKI), subjekti ka deklaruar se në bazë të kontratës për kalim të drejtash, datë 29.5.2012, ka blerë apartamentin 1+1, me sipërfaqe 84.6 m² me nr. ***, në katin e katërt të banimit në godinën e ndërtuar nga shoqëria “****”. Në vijim ka sqaruar se ky apartament fillimisht ishte porositur⁵⁶ nga shtetasi Sh.A., i cili hoqi dorë nga kjo e drejtë kundrejt çmimit 40,000 euro.

53.3. Si burim krijimi ka deklaruar shumën 5,000 euro, të kursyera prej tij ndër vite, si edhe shumën 35,000 euro, të marrë hua nga vëllai i tij, z. P.N. Subjekti ka shpjeguar se ka marrë me kontratë huaje nga vëllai i tij shumën 5,500,000 lekë, e cila do shlyhej deri në datën 30.12.2017 si vijon: (i) 3,700,000 lekë në momentin e disbursimit të kredisë nga “ProCredit Bank”; dhe (ii) shuma 1,800,000 lekë në momentin e shitjes së automjetit në pronësi të tij, i markës “Mercedes-Benz”, me targë ***.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

54. ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Veri⁵⁷ nuk konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie. Me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues⁵⁸: (i) kontratë kalimi të drejtash (dorëzim apartamenti) me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.5.2012; dhe (ii) kontratë porosie me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.4.2007.

54.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se në datën 14.4.2007 shtetasi Sh.A., ka porositur nga shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin nr. ***, me sipërfaqe 84.6 m², të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

54.2. Sipas kontratës së porosisë likuidimi i çmimit do të bëhej me lidhjen e saj, por nuk përcaktohet çmimi i shitjes..

54.3. Në datën 29.5.2012, mes subjektit të rivlerësimit në cilësinë e porositësit të dytë, z. Sh.A., në cilësinë e porositësit të parë dhe shoqërisë “****” sh.p.k. në cilësinë e shoqërisë ndërtuese, është lidhur kontrata për kalim të drejtash (dorëzim apartamenti) për pasurinë e llojit “apartament”, me përbërje 1+1, nr. ***, me sipërfaqe 84.6 m², të ndodhur në godinën e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në rrugën “****”, Tiranë, pasuri kjo e porositur në datën 14.4.2007 nga shtetasi Sh.A., (si më sipër).

54.5. Sipas kësaj kontrate, z. Sh.A., heq dorë nga kjo pasuri dhe bëhet kalimi i të drejtave të pronësisë në favor të subjektit të rivlerësimit, duke u bërë dhe dorëzimi i apartamentit. Vlera e blerjes është 40,000 euro, likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Në kontratë pasqyrohet edhe burimi i krijimit të shumës së paguar nga subjekti i rivlerësimit, e konkretisht shuma 35,000 euro, e marrë hua nga vëllai i tij, z. P.N., dhe shuma 5,000 euro nga kursimet e tij personale.

54.6. Bashkëlidhur dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri konstatohet deklarata e plotësuar me shkrim të lirë dore nga shtetasi R.A., që mban datën

⁵⁵ Kontrata me nr. *** rep., nr. *** kol, datë 29.5.2012.

⁵⁶ Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.4.2007.

⁵⁷ Shkresa nr. ***prot., datë 6.9.2019.

⁵⁸ Aneksi *** në dosjen e ILDKPKI-së.

29.5.2012, sipas së cilës ai deklaroi se ka marrë për llogari të Ç., shumën 40,000 euro nga shitja e apartamentit.

54.7. Gjithashtu, rezultoi se në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka filluar të jetojë në këtë apartament që prej shtatorit të vitit 2012.

54.8. OSHEE-ja⁵⁹ konfirmon se nga të dhënat e faturimit subjekti i rivlerësimit identifikohet si abonent me kontratën e furnizimit në instancën e Tiranës, në objektin e ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, kabina “***”. Nga verifikimi i dokumentacionit që i përket planit të pagesave për kontratën e lidhur për apartamentin objekt hetimi rezultoi se deri në korrik të vitit 2012 janë shlyer/paguar vetëm tarifa fikse shërbimi dhe se pas kësaj periudhe janë kryer pagesa për furnizim me energji elektrike.

54.9. UKT-ja⁶⁰ informon se subjekti i rivlerësimit identifikohet si abonent me kontratën nr. ***, me adresë: rruga “***”, Tiranë, me status “aktiv”, në kategorinë e konsumatorëve familjarë. Sipas dokumentacionit konstatohet se fillimisht kontrata e këtij shërbimi është lidhur me z. R.A. Ndryshimi i emrit të kontratave për ujë të pijshëm dhe energji elektrike është bërë me deklaratën noteriale dypalëshe të datës 23.7.2012 për dhënien e pëlqimit, si dhe pas kërkesës së subjektit të rivlerësimit të datës 26.7.2012.

55. Siç dihet, elementet e marrëdhënies juridike janë objekti, përmbajtja dhe subjektet e saj. Subjektet, si elementë përbërës të marrëdhënies juridike, janë personat që marrin pjesë në cilësinë e mbajtësit të të drejtave dhe detyrimeve juridike përkatëse.

55.1. Komisioni kreu verifikime në sistemin TIMS për shtetasin Sh.F.A., i datëlindjes 6.4.1985, me të cilin subjekti ka hyrë në një marrëdhënie juridike civile, duke nënshkruar kontratën e datës 29.5.2012. Rezultoi se ky shtetas nuk ka qenë në territorin shqiptar në datën e nënshkrimit të kontratës⁶¹.

Neni 659 i Kodit Civil përcakton se “kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”, ndërsa në nenin 79 të Kodit Civil përcaktohet se “veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”.

55.2. Sa më sipër, duket se veprimi juridik është nul, pasi nuk ekziston vullneti për kryerjen e tij. Gjithashtu, në vështrimin tërësor të dispozitave që rregullojnë institutin e pavlefshmërisë së veprimeve juridike konsiderohet absolutisht i pavlefshëm veprimi juridik, i cili, për shkak të shkeljes së ligjit ose për shkak tjetër të parashikuar në ligj, nuk ka fuqi juridike ose është i paaftë të sjellë pasojat juridike të synuara nga palët⁶². Rrjedhimisht, referuar dispozitave të mësipërme kontrata për kalim të drejtash për blerjen e këtij apartamenti nga subjekti i rivlerësimit është veprim juridik i dyanshëm, për të cilin mungon shfaqja e ligjshme e vullnetit, pasi shtetasi Sh.A., nuk gjendej në territorin shqiptar në momentin e nënshkrimit të saj.

55.3. Konstatohet gjithashtu se e gjithë marrëdhënia për blerjen e pasurisë është krijuar me shtetasin R.A., (identifikuar si xhaxhai i shtetasit Sh.A.) dhe se kontrata është nënshkruar në mungesë të palës tjetër. Duke konsideruar faktin se subjekti ka pasur njohuri të mira ligjore, ngrihen dyshime të arsyeshme për marrëdhënien e tij me shtetasit e sipërcituar dhe vetëbesimit të tepruar për pagimin dhe dorëzimin e çmimit të blerjes në një shumë të konsiderueshme një personi të ndryshëm nga ai i cili mbante të drejtat reale mbi pasurinë objekt hetimi.

⁵⁹ Shkresa nr. ***prot., datë 9.8.2019.

⁶⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 7.8.2019.

⁶¹ Referuar të dhënave të përfituara nga sistemi TIMS konstatohet se ky shtetas ka dalë nga territori shqiptar në datën 29.5.2010 në pikën kufitare të Morinës dhe ka hyrë në territorin shqiptar në datë 2.1.2013, po nëpërmjet kësaj pike kufitare.

⁶² Referohu nenit 92 të Kodit Civil.

55.4. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, pasi me veprime aktive ka marrë pjesë në nënshkrimin e një kontrate në mungesë të palës tjetër dhe shfaqjes së ligjshme të vullnetit të saj. Kontrata, e cila është paraqitur në institucionet publike, ngre dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tërësisë së kësaj marrëdhënieje juridike.

55.5. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet e tij dhe provat e mundshme në lidhje me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

56. Subjekti ka pretenduar se shtetasi Sh.A., ka qenë prezent në momentin e nënshkrimit të kontratës, duke pretenduar se sistemi TIMS nuk “tregon” gjithçka dhe as nuk provon vendndodhjen, e aq më pak në kalimet kufitare për në Kosovë, Maqedoni apo edhe Mal të Zi, ku në shumë raste mund të regjistrohet dalja dhe të mos regjistrohet hyrja dhe anasjelltas.

56.1. Për të mbështetur deklaratimet e tij subjekti ka depozituar si dokumentacion provues: (i) deklaratë noteriale⁶³ të shtetasit Sh.A., nëpërmjet të cilës ky shtetas deklaroi se ka qenë i pranishëm në momentin e nënshkrimit të kontratës; si edhe (ii) katër kartela dentare për trajtim pacientësh, nëpërmjet të cilave pretendohet se Dr. Sh.A., ka trajtuar pacientë në klinikën e tij në Tiranë, në datat 12.5.2012; 25.5.2012; 29.5.2012; dhe 30.5.2012.

Analiza përfundimtare e kryer nga Komisioni /vlerësimi i provave

57. Komisioni vëren se, megjithëse subjekti ka depozituar si dokumentacion provues kartelat dentare për shërbime të pretenduara si të kryera nga Dr. Sh.A., në muajin maj të vitit 2012, nga ana tjetër nuk është depozituar dokumentacion për të dhënat e regjistrimit të kësaj klinike apo të dhëna të punësimit të këtij shtetasi për këtë periudhë. Për më tepër, nga verifikimi i faqes zyrtare të QKB-së, Komisioni konstatoi se z. Sh.A., figuron i regjistruar në këtë organ në datën 28.8.2015.

57.1. Si konkluzion, nga analiza e shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmon se ato nuk janë bindëse dhe nuk provojnë të kundërtën e rezultateve të hetimit. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm që shtetasi Sh.A., gjendej në Shqipëri dhe, si rrjedhojë, i pranishëm në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Analiza ligjore/financiare e burimeve të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie

58. Sikurse u tha më lart, si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (i) shumën 5,000 euro si kursime personale ndër vite; (2) shumën 35,000 euro, pjesë e huas së marrë nga të tretët; dhe (3) kredinë bankare të marrë në vitin 2012.

Shuma 5,000 euro, deklaruar si kursime personale ndër vite

58.1. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës⁶⁴ subjekti ka deklaruar si kursime gjendjen *cash* shumën 150,000 lekë, me burim krijimi të ardhurat e fituara nga fitimet ndër vite të shoqërisë “***” sh.p.k, dhe shitja e kuotave, të cilat ai zotëronte në këtë shoqëri.

⁶³ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.2.2020.

⁶⁴ Dorëzuar në ILDKPKI në datën 6.2.2009.

58.2. QKB-ja⁶⁵, konfirmon se subjekti i rivlerësimit figuron të ketë qenë ortak me 33% të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., (shoqëri e krijuar në vitin 2007) dhe se është larguar prej saj në datën 17.7.2008. Konstatohet se në datë 1.7.2008 subjekti ka shitur⁶⁶ kuotat që zotëronte në këtë shoqëri, në total për vlerën 33,000 lekë.

58.3. DRT-ja Lezhë⁶⁷ konfirmon se shoqëria “****” sh.p.k., për vitin 2007 ka shpërndarë dividendin në shumën 166,800 lekë dhe ka paguar tatimin për dividendin në shumën 16,680 lekë. Si rrjedhim, duke konsideruar se subjekti ka zotëruar 33% të aksioneve të kësaj shoqërie, ai ka përfituar shumën neto rreth 50,000 lekë.

58.4. Për sa më sipër duket se, të ardhurat neto të përfituara nga subjekti i rivlerësimit si aksioner i shoqërisë “****” sh.p.k., janë në vlerën 83,000 lekë dhe se kjo shumë nuk është e mjaftueshme për të krijuar kursimet në shumën 150,000 lekë, të deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës.

58.5. Pas kalimit të barrës së provës subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në momentin e plotësimit të deklaratës përpara fillimit të detyrës ka pasur në *cash* shumën 150,000 lekë dhe se të ardhurat e tij kanë qenë mëse të mjaftueshme për të justifikuar kursimet në këtë vlerë, pasi për periudhën 2006 – 2008 ai është paguar si magjistrat⁶⁸ në shumën totale 981,375 lekë, të ardhura këto të deklaruara në deklaratën “Vetting”.

58.6. Nga vlerësimi i shpjegimeve dhe provave të depozituara për dokumentimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të shumës 150,000 lekë si pasuri gjendje *cash* në momentin para fillimit të detyrës, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të mundësuar plotësisht krijimin e kësaj shume. Pasaktësia në deklarin e burimit të krijimit të saj në deklaratën fillestare të pasurisë, duke konsideruar edhe vlerën e deklaruar si gjendje *cash*, vlerësohet se ka peshë specifike të vogël dhe, për sa kohë nuk cenohet burimi i krijimit të kësaj shume, nuk do të merret në konsideratë në vendimmarrje.

58.7. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 subjekti ka deklaruar shumën 500,000 lekë gjendje kursimesh *cash*, të dhuruara nga pjesëmarrësit në ceremoninë e martesës së tij, e konkretisht të paralindurit, kushërinjtë deri në shkallë të tretë dhe shoqëria e ngushtë.

58.8. Konstatohet se kjo shumë krahas deklaramit në rubrikën “dhurime dhe trajtime preferenciale” është deklaruar edhe në rubrikën e të ardhurave. Ndërkohë, referuar vetëdeklarimit të bërë nga subjekti, kjo shumë është plotësisht e kursyer, pra, shtesë pasurie përgjatë vitit 2010.

58.9. Në përputhje me germen “c” të pikës 1 të nenit 5 dhe germen “b” të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, subjekti ka patur detyrimin të deklarojë identitetin e personave fizikë/juridikë prej nga vijnë apo krijohen dhuratat, kur vlera e dhuruar është mbi 10,000 lekë.

60. Gjithashtu, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar subjekti nuk ka referuar dhurimin e shumës 500,000 lekë, si burim fillestar i krijimit të shumës 5000 euro, të deklaruar si burim për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit në vitin 2012.

60.1. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit duket se gjendja e kursimeve *cash* të deklaruara deri në fund të vitit 2011, rezulton në shumën 650,000 lekë, e cila korrespondon afërsisht me

⁶⁵ Shkresa nr. ***prot., datë 27.8.2019.

⁶⁶ Kontrata me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.7.2008.

⁶⁷ Shkresa me nr. *** prot.

⁶⁸ Vërtetimi i Shkollës së Magjistraturës me nr. *** prot., datë 17.2.2020.

shumën 5,000 euro, të vetëdeklaruar në DPV/2012 dhe në deklaratën “Vetting” si kursime që kanë shërbyer si burim për kryerjen e pagesës për blerjen e apartamentit.

60.2. Lidhur me shumat e deklaruara si të dhuruara dhe të kursyera gjatë vitit 2010, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar se në ceremoninë martesore të dasmës së tij kanë marrë pjesë rreth 100 persona madhorë dhe se shuma e dhuruar prej secilit prej tyre nuk e ka tejkaluar vlerën 10,000 lekë.

60.3. Nga analiza në harmoni e deklarimeve të bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI me deklarimet e bëra gjatë hetimit administrativ dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si edhe duke vlerësuar faktin se edhe në kontratën e kalimit të të drejtave të pasurisë “apartament” është referuar si burim shuma 5,000 euro si kursime personale ndër vite, Komisioni krijoi bindjen se kjo ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi dhe se nuk ka dyshime për burimin e krijimit të saj.

Shuma 35,000 euro, marrë hua nga të tretët

61. Referuar DPV/2012 dhe deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting” (shtojca 2), subjekti ka deklaruar si burim krijimi për kryerjen e pagesës për blerjen e apartamentit në vitin 2012, huan e marrë nga vëllai i tij, z. P.N., në shumën 35,000 euro.

61.1. Lidhur me këtë marrëdhënie huaje, subjekti ka depozituar në ILDKPKI⁶⁹ dokumentet si vijon: (i) kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.2012; (ii) revokim kontrate nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.6.2012; dhe (iii) kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.6.2012.

61.2. Nga kontrata e huas së datës 4.6.2012 konstatohet se vëllai i subjektit, z. P.N., deklaroi se ka dhënë hua shumën 5,500,000 lekë, për të cilën subjekti deklaroi se e ka marrë në datën 29.5.2012 për të paguar banesën e blerë me kontratën e po kësaj date. Në këtë kontratë huaje parashikohet se: (i) kësti i parë në shumën 4,000,000 lekë do të shlyhet në momentin e marrjes së kredisë nga “BKT”-ja; dhe (ii) kësti i dytë në shumën 1,500,000 lekë do të likuidohet pas daljes në marrëdhënie pune të bashkëshortes, znj. A.Ll., i cili përcaktohet për t’u paguar deri më 30.12.2017.

61.1. Në datën 22.6.2012 kontrata e huas e sipërcituar është revokuar/ anuluar me arsyen se BKT-ja nuk akordoi kredinë në favor të huamarrësit, si rrjedhim, palët u kthyen në gjendjen fillestare. Po në datën 22.6.2012 është lidhur kontrata e huas sipas së cilës vëllai i subjektit, z. P.N., deklaroi se ka dhënë hua shumën 5,500,000 lekë, për të cilën subjekti deklaroi se e ka marrë në datën 29.5.2012. Në këtë kontratë huaje parashikohet se: (i) kësti i parë në shumën 3,700,000 lekë do të shlyhet në momentin e akordimit të kredisë në favor të huamarrësit në “ProCredit Bank”; dhe (ii) kësti i dytë në shumën 1,800,000 lekë do të likuidohet pas shitjes së mjetit tip “Benz”, me targë ***. Gjithashtu, në kontratë parashikohet se këto këste do të likuidohen deri në datën 30.12.2017.

61.2. Në zbatim të pikës 14 të nenit 3 si edhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. P. N., bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast, bazuar në parimin e proporcionalitetit për shumën 5,500,000 lekë, të dhënë hua në datën 29.5.2012.

61.3. I pyetur nga Komisioni⁷⁰ se cili ka qenë burimi i të ardhurave të vëllait për krijimin e kësaj shume, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se *vëllai i ka bërë me dije se si burim*

⁶⁹ Aneksi *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁰ Pyetësori nr. 2.

*i kësaj shume është përdorur llogaria kontratë kredie me kufi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.3.2011 dhe të ardhurat e përfituara si ortak i shoqërisë “***”.*

61.4. Sipas kontratës së kredisë me kufi të datës 4.3.2011, si subjekt kredimarrës shfaqet shoqëria “***” sh.p.k. dhe se kjo *kredi-overdraft* është dhënë nga “Raiffeisen Bank” sh.a., me kërkesë të kredimarrësit deri në shumën 30,000,000 lekë, e cila do të autorizohet në llogarinë e klientit, nga të cilat 15,000,000 lekë do transferoheshin në llogarinë e shitësve/furnitorëve përkundrejt faturave dhe pjesa e mbetur *cash* në llogarinë e klientit. Nga dokumentacioni konstatohet se kontrata e kredisë me kufi është ndryshuar (zgjatje afati) në vitin 2012 dhe 2013.

61.5. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së shoqërisë “***” sh.p.k., në “Raiffeisen Bank” (llogaria në ALL me nr. ***) konstatohet se pas nënshkrimit të kësaj kontrate, përgjatë vitit 2011 administratori i shoqërisë, z. Sh.N., ka kryer disa tërheqje *cash* në shuma të konsiderueshme.

61.6. Ndërkohë, nga analiza e pasqyrave financiare të vitit 2011 të shoqërisë “***” sh.p.k., konstatohet se gjendja e *overdraftit* (kredisë me kufi) në datën 31.12.2011 është në vlerën 7,168,602 lekë dhe nuk rezulton të jenë pasqyruar të drejta/llogari/kërkesa të tjera të arkëtueshme nga ortakë, gjendje në datën 31.12.2011. Për më tepër, gjendja e arkës së shoqërisë në datën 31.12.2011 është në vlerën 0 (zero) lekë.

61.7. Pra, duket se në datën 31.12.2011, nga kredia me kufi *overdraft* me limit 30,000,000 lekë, gjendja e mbetur është 7,168,602 lekë dhe se ortakët nuk kanë asnjë detyrim të mbetur ndaj shoqërisë, që do të thotë, nuk kanë përfituar si individë/ortakë vlera monetare nga kjo kredi deri në këtë datë.

61.8. Komisioni verifikoi lëvizjet e llogarisë së mësipërme për periudhën 1.1.2012 – 29.5.2012 (data e dhënies së huas në favor të subjektit), nga ku rezultoi se nga kjo llogari nuk ka patur tërheqje/transferta nga/për ortakët e shoqërisë, por se ajo është përdoruar për likuidime detyrimesh të ndërsjellta mes kësaj shoqërie dhe klientëve apo furnitorëve të saj.

61.9. Sa më sipër, Komisioni konstatoi se kredia me kufi *overdraft*, i marrë nga shoqëria “***” sh.p.k., më 4.3.2011, në “Raiffeisen Bank”, nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi i të ardhurave të vëllait, z. P.N., të pretenduara nga subjekti se kanë shërbyer për dhënien e huas në datën 29.5.2012.

62. Në këtë kuptim, duket se personi tjetër i lidhur nuk ka patur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien e huas në datën 29.5.2012, në shumën 5,500,000 lekë, në favor të subjektit të rivlerësimit, deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

62.1. Bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të dhënë argumentet/shpjegimet e tij dhe provat e mundshme në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

63. Me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se vëllazërit e tij kanë angazhuar një auditues ligjor për këtë çështje. Referuar raportit të audituesit ligjor⁷¹, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se si burim krijimi i shumës së dhënë hua nga vëllai i tij z. P.N., (aksioner i vetëm i shoqërisë), kanë qenë të ardhurat e akumuluar në arkën e shoqërisë nga shitjet e realizuara nga data 1.1.2012 – 31.5.2012.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

⁷¹ Raporti i audituesit ligjor D. A. (nr. licence ***).

64. Nisur nga pretendimet dhe provat e parashtruara rishtazi nga subjekti i rivlerësimit lidhur me të ardhurat, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i shumës së dhënë hua, Komisioni, pas riçeljes, kreu hetime shtesë duke administruar, ndër të tjera, librat e shitblerjes si edhe FDP-të e TVSH-së të subjektit “***”, për periudhën janar – maj 2012⁷².

64.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për këtë subjekt konstatohet se blerjet përgjatë kësaj periudhe janë në vlera më të larta se shitjet e realizuara. Lidhur me këtë fakt, në pretendimet e subjektit dhe në raportin e audituesit ligjor është parashtruar se blerjet gjatë kësaj periudhe janë kryer me të ardhurat gjendje në llogarinë bankare (në lekë) linjë *overdraft* në emër të shoqërisë “***” sh.p.k.

64.2. Megjithëse konfirmohet fakti se për këtë periudhë janë debituar nga llogaritë e shoqërisë (llogaria *overdraft* në lekë dhe një llogari tjetër në valutën dollarë⁷³) vlera monetare, të cilat, në tërësinë e tyre mbulojnë vlerën totale të blerjeve për këtë periudhë, për sa kohë vërehet se në llogarinë në dollarë ka kreditime në *cash* nga përfaqësuesit e shoqërisë, të papasqyruara në raportin e audituesit ligjor, trupi gjykues krijoi bindjen se rezultati i paraqitur nga audituesi ligjor për gjendjen e arkës së shoqërisë në datën 29.5.2012 nuk përfaqëson situatën reale dhe se nuk ka qenë e mundur krijimi i kësaj shume, e cila është deklaruar si e dhënë hua për subjektin e rivlerësimit.

64.3. Për më tepër, kjo marrëdhënie e pretenduar e z. P.N., me shoqërinë “***” sh.p.k., nuk është pasqyruar bilancin e vitit 2012, pasi duke mbajtur në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit i ka kthyer gjatë këtij viti vetëm shumën 3,700,000 lekë, në pasqyrat financiare nuk është reflektuar shuma e mbetur 1,800,000 lekë, si shumë e dhënë hua nga shoqëria aksionerit të saj.

64.4. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk është bindës në shpjegimet dhe provat e depozituara prej tij, duke mos arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, kjo në këndvështrimin edhe të ndryshimit të deklarimeve të tij lidhur me të ardhurat e vëllait, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i shumës së dhënë hua. Si rrjedhim, trupi gjykues arrin në përfundimin se personi tjetër i lidhur, z. P.N., nuk ka patur burime financiare të ligjshme për të mundur shumën e dhënë hua në datën 29.5.2012, në vlerën 5,500,000 lekë, në favor të subjektit të rivlerësimit.

64.5. Për sa i përket të ardhurave të përfituara nga vëllai i subjektit, z. P.N., nga ushtrimi i aktivitetit tregtar i shoqërisë “***” sh.p.k., DRT-ja Lezhë⁷⁴, konfirmon se për periudhën 2007 – 2011 kjo shoqëri: (i) për vitin 2007 ka shpërndarë dividendin në shumën 166,800 lekë dhe ka paguar tatimin për dividendin në shumën 16,680 lekë; dhe (ii) për vitin 2010 ka shpërndarë dividendin në shumën 2,058,300 lekë dhe ka paguar tatimin për dividendin në shumën 205,830 lekë. Duke konsideruar faktin se në momentin e shpërndarjes së dividendit të vitit 2007 shoqëria ka patur 3 aksionerë dhe z. P.N., zotëronte 33% të kuotave të shoqërisë dhe se në momentin e shpërndarjes së dividendit të vitit 2010 z. P.N., ka qenë ortak i vetëm i kësaj shoqërie, përlllogaritet se ai ka përfituar të ardhura neto në formë dividenti për këtë periudhë vlerën 1,902,000 lekë.

64.6. ISSH-ja⁷⁵ konfirmon se për periudhën 1.1.2012 – 30.5.2012, z. P.N., ka përfituar si të ardhura nga paga shumën neto 105,230 lekë. DRSSH-ja Lezhë⁷⁶ konfirmon se për periudhën 2007 – 2011, z. P.N., ka përfituar si të ardhura nga paga për të cilat janë paguar kontributet

⁷² Shkresa e DPT-së nr. *** prot., datë 29.9.2020.

⁷³ Llogaria e shoqërisë në dollarë nuk është përmendur në raportin e audituesit ligjor dhe si rrjedhojë, kredimet dhe debitimet e saj nuk janë përfshirë në analizën e gjendjes së arkës.

⁷⁴ Shkresa me nr. ***prot., datë 2.8.2019.

⁷⁵ Shkresa me nr. *** prot., datë 27.07.2017.

⁷⁶ Shkresa me nr. *** prot., datë 31.10.2019.

shumën 1,223,420 lekë. ISSH-ja⁷⁷ konfirmon se për periudhën janar – maj 2012, z. P.N., ka përfituar si të ardhura bruto nga paga për të cilat janë paguar kontributet shumën 130,000 lekë.

64.7. Gjithsesi, duke vlerësuar se në prapësimet përfundimtare subjekti ka parashtruar se si burim krijimi i shumës 5,500,000 lekë kanë shërbyer vetëm të ardhurat nga shitjet e realizuar të shoqërisë për periudhën 1.1.2012 – 29.5.2012, si edhe në kushtet kur z. P.N., ka kryer edhe shpenzime gjatë kësaj periudhe, Komisioni çmon se të ardhurat e referuara më sipër (nga dividendi dhe paga) nuk do të konsiderohen si burim krijimi për shumën 5,500,000 lekë të pretenduar si e dhënë hua në favor të subjektit të rivlerësimit.

64.8. Bazuar në analizën financiare/ligjore të burimeve të krijimit (të deklaruara nga subjekti) të pasurisë objekt vlerësimi, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën në shumën 40,000 euro, të kryer në datën 29.5.2012 për kalimin e të drejtave mbi pasurinë e llojit “apartament banimi”.

Shlyerja e huas së marrë nga vëllai, z. P.N.

65. Në deklaratën “Vetting”, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar shumën e marrë hua nga vëllai në vitin 2012, në vlerën 5,500,000 lekë dhe detyrimin e mbetur pa shlyer në shumën 300,000 lekë.

65.1. Deklarimi i kësaj huaje ndër vite: (1) referuar DPV/2012, subjekti ka deklaruar huan e marrë nga vëllai në shumën 5,500,000 lekë, prej së cilës ka shlyer shumën 3,700,000 lekë nga kredia e marrë në “ProCredit Bank”. Gjendja e detyrimit në datën 31.12.2012 është në shumën 1,800,000 lekë; (2) referuar DPV/2013, subjekti ka deklaruar detyrimin e mbetur nga huaja e marrë vëllait në vlerën 1,800,000 lekë; (3) referuar DPV/2014, subjekti ka deklaruar shlyerjen e shumës 1,300,000 lekë në favor të vëllait të tij me burim të ardhurat nga shitja e automjetit, nga qiraja dhe nga paga e bashkëshortes dhe se, detyrimi i mbetur pa shlyer është në shumën 500,000 lekë; (4) referuar DPV/2015, subjekti ka deklaruar shlyerjen në shumën 200,000 lekë me burim të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, detyrimi i mbetur në shumën 300,000 lekë.

Kredia e marrë nga subjekti në “ProCredit Bank”

66. “ProCredit Bank”⁷⁸ konfirmon se në datën 29.6.2012 subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e kredisë për marrjen e shumës 3,700,000 lekë, me destinacion të përcaktuar “për blerje banese”⁷⁹. Sipas dokumentacionit konfirmohet se kjo kredi është disbursuar në llogarinë e subjektit në datën 29.6.2012 dhe në datën 2.7.2012, shuma 3,700,000 lekë është transferuar në favor të vëllait të subjektit, z. P.N., me përshkrimin “kthim borxhi”.

66.1. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë kredinë e marrë në “ProCredit Bank”, detyrimin e shlyer dhe gjendjen e detyrimit të mbetur për periudhat përkatëse të deklaramit.

Autovetura e markës “Mercedes – Benz”, tipi “Daimler Chrysler C220 CDI”

67. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës⁸⁰ konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit “autoveturë” të markës “Mercedes – Benz”, tipi “Daimler Chrysler C220CDI”.

⁷⁷ Shkresa me nr. *** prot., datë 5.8.2019.

⁷⁸ Shkresa me nr. OP -*** prot., datë 6.8.2019.

⁷⁹ Referohu nenit 2 të kontratës së kredisë.

⁸⁰ Dorëzuar në datën 6.2.2009 në ILDKPKI.

Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar kontratën e dhurimit⁸¹ të datës 24.1.2009. Ndërsa, në DPV/2014 subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti, në vlerën 1,200,000 lekë.

67.1. Me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues⁸²: (i) kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.8.2008; (ii) kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.1.2009; (iii) kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.12.2014 plus mandatbankar nga “Raiffeisen Bank”, datë 27.11.2014; dhe (iv) urdhërpagesë datë 5.12.2014 për pagesën e tatimit në burim.

67.2. DPSHTRR-ja⁸³ konfirmon se subjekti i rivlerësimit, z. Bib Ndreca, ka pasur të regjistruar në emrin e tij automjetin me targë *** (që përkon me automjetin me targë ***). Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ky institucion, si edhe dokumentacionit të depozituar nga vetë subjekti për këtë automjet konstatohet se: (i) në datën 18.8.2008 ky automjet është blerë nga vëllai i subjektit, z. Sh.N., në shumën 12,000 euro; (ii) në datën 24.1.200, ky automjet i dhurohet subjektit të rivlerësimit; (iii) në datën 3.12.2014, subjekti e ka shitur këtë automjet në shumën 1,200,000 lekë dhe në datën 5.12.2014 ka paguar tatimin në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti.

67.3. Në zbatim të pikës 14 të nenit 3, si edhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. Sh. N., bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast, bazuar në parimin e proporcionalitetit, të shumës 12,000 euro, që ka shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie prej tij, të dhuruar në favor të subjektit të rivlerësimit.

67.4. I pyetur nga Komisioni se cili ka qenë burimi i të ardhurave të vëllait të tij, z. Sh.N., subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se *burimi i krijimit janë të ardhurat e vëllait nga aktiviteti tregtar deri në vitin 2007 si person fizik, të ardhurat si ortak themelues i personit juridik “***” sh.p.k. dhe kursimet e tij ndër vite.*

67.5. Në mbështetje të deklaratimit subjekti ka depozituar si dokumentacion provues: (i) kopje të vendimit të gjykatës për regjistrimin e personit fizik Sh.N.; (ii) ekstrakt historik i regjistrit tregtar i subjektit “***” sh.p.k., pasqyra financiare të shoqërisë; dhe (iii) kopje të dy mandatpagesave bankare për dokumentimin e depozitimit të të ardhurave të z. Sh.N., në bankë (mandatpagesë nga Banka e Kursimeve datë 24.9.2003, sipas së cilës vëllai subjektit, z. Sh. N., tërheq shumën 10,945 euro dhe urdhërderdhje datë 24.3.2004 në Bankën e Kursimeve, sipas së cilës vëllai subjektit, z. Sh.N., ka depozituar në llogarinë e tij shumën 1,300,000 lekë).

Analiza ligjore/financiare e burimeve të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie

68. Nga analiza e kryer më sipër rezultoi se të ardhurat e përfitura nga ushtrimi i aktivitetit tregtar si person fizik, subjekti “***” janë referuar edhe si burim krijimi i pasurive të llojit “tokë arë”, të blera përgjatë viteve 2004 – 2005, të regjistruara në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me vëllezërit e tij. Dokumentacioni dorëzuar nga subjekti edhe i dërguar nga DRT-ja Lezhë referon qarkullim të realizuar për vitet 2003 – 2005 nga subjekti “***”, person fizik, në total shumën 2,500,000 lekë, ndërsa për vitet pasardhëse nuk ka të dhëna. Kjo shumë përfaqëson qarkullimin bruto të realizuar nga ky aktivitet, pa konsideruar gjithë shpenzimet e mundshme operationale dhe fikse.

⁸¹ Kontrata me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.1.2009.

⁸² Aneksi ***në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸³ Shkresa me nr. *** prot., datë 9.8.2019.

68.1. Për sa u përket të ardhurave të përfituara nga vëllai subjektiv, z. Sh.N., nga ushtrimi i aktivitetit tregtar i shoqërisë “****” sh.p.k., DRT-ja Lezhë⁸⁴, konfirmon se kjo shoqëri: (i) për vitin 2007 ka shpërndarë dividendin në shumën 166,800 lekë dhe ka paguar tatimin për dividendin në shumën 16,680 lekë. Duke konsideruar faktin se në momentin e shpërndarjes së dividendit të vitit 2007 shoqëria ka patur 3 aksionerë dhe z. Sh.N., zotëronte 34% të kuotave të shoqërisë, përlllogaritet se ai ka përfiturar të ardhura neto në formë dividenti për këtë periudhë vlerën rreth 51,040 lekë.

68.2. Ndërsa, referuar të dhënave të dërguara nga DRSSH-ja Lezhë⁸⁵, konfirmohet se të ardhurat e z. Sh.N., nga pagat mbi të cilat janë derdhur kontributet, si administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën prill 2007 - gusht 2008 kanë qenë në shumën 575,556 lekë.

68.3. Duke vlerësuar të dhënat e mësipërme duket se, z. Sh.N., në cilësinë e personit tjetër të lidhur, nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen e automjetit të markës “Mercedes - Benz”.

68.4. Bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit për të dhënë argumentet/shpjegimet e tij dhe provat e mundshme në lidhje me këtë konstatim.

68.5. Nëpërmjet prapësimeve të depozituara në Komisionin subjektivit të rivlerësimit ka parashtruar se kjo pasuri është e krijuar para fillimit të detyrës dhe se i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke deklaruar se si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat e vëllait të tij z. Sh.N.

68.6. Subjektivit me dërgimin e prapësimeve ka depozituar si prova të reja (krahas mandateve të pasqyruar më sipër, të depozituara në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit): (i) mandatar-këtimi në bankën e kursimeve në llogari të Sh.N., datë 1.10.1999, në shumën 370,000 dhrami; (ii) urdhërderdhje në “Raiffeisen Bank” në llogarinë e Sh.N., në datën 21.2.2005 në shumën 166,000 lekë; (iii) urdhërderdhje, datë 30.3.2004, në Bankën e Kursimeve në llogarinë e Sh.N., në shumën 1,300,000 lekë; (iv) akt që referon depozitë në marka gjermane në Bankën e Kursimeve, datë 15.2.2000 për një depozitë 10,048 marka (i padallueshëm qartë); dhe (v) *statement* bankar në “Raiffeisen Bank” i llogarisë në lekë të z. Sh.N., nga ku duket se në datën 16.5.2008 është tërhequr shuma 1,500,125 lekë.

68.7. Në vijim, nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se kjo pasuri është blerë nga vëllai i subjektivit të rivlerësimit para se ky i fundit të merrte emërimin e përkohshëm nga Presidenti i Republikës për të kryer stazhin profesional si gjyqtar⁸⁶.

68.8. Duke vlerësuar faktin se ekzistojnë *indicie* dhe të dhëna të besueshme për punën e kryer në emigracion si edhe për aktivitetin si person fizik të vëllait të subjektivit z. Sh.N., faktin se ky shtetas duket se ka kryer transaksione në vlera të konsiderueshme para blerjes së kësaj pasurie (vetëm tre muaj para blerjes ka tërhequr nga banka shumën rreth 1.5 milion lekë)⁸⁷, si edhe të faktit se kjo pasuri është blerë nga vëllai i subjektivit para fillimit të detyrës prej tij dhe i është dhuruar vetëm rreth 17 ditë pas fillimit të detyrës⁸⁸, si konkluzion trupi gjykues çmon se nuk mund të ngrejë dyshime për krijimin e kësaj pasurie dhe se analizimi i burimeve financiare që kanë shërbyer për blerjen e saj nga personi i lidhur nuk mund të jetë pjesë dhe nuk ndikon në procesin e rivlerësimit dhe vendimmarrjen për këtë subjektiv.

⁸⁴ Shkresa me nr. *** prot., datë 2.8.2019.

⁸⁵ Shkresa me nr. *** prot., datë 30.10.2019.

⁸⁶ Referohu shkresës së Gjykatës së Tiranës nr. ***prot., datë 29.9.2020.

⁸⁷ Fonde të cilat në asnjë rast nuk lidhen me subjektivin e rivlerësimit.

⁸⁸ Subjektivit ka filluar detyrën me emërimin e përkohshëm për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në datën 7.1.2009 dhe automjeti i është dhuruar në datën 24.1.2009. Gjithashtu rezultoi se çështja e parë e mbyllur nga subjektivit (vendimi i dhënë) mban datën 17.2.2009.

69. Pasuri e llojit “automjet” i markës “Smart”, tip “Micro” (e deklaruar veçmas nga bashkëshortja e subjektit), vit prodhimi 2001, blerë⁸⁹ në datën 7.11.2011, për vlerën 2,800 euro. Si burim krijimi të kësaj pasurie personi i lidhur deklaroi: (i) shumën 1,800 euro të dhuruar nga vëllai i saj dhe shumën 1,000 euro dhuratë nga kunati. Në vijim të deklarimit bashkëshortja e subjektit ka shpjeguar se vëllai i saj jeton dhe punon si emigrant në Itali, ndërsa kunati ushtron aktivitet tregtar.

69.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: referuar DPV/2011, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka deklaruar së në datën 7.10.2011 ka blerë e autoveturën e tipit “Smart”, me targë ***, me burim krijimi shumën 1,800 euro, të dhuruar nga vëllai i saj, z. E.Ll., dhe shumën 1,000 euro të dhuruar nga kunati, z. Sh.N.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

69.2. DPSHTRR-ja⁹⁰, konfirmon se në emër të personit të lidhur ka qenë i regjistruar mjete me targë ***. Nga verifikimi i dosjes konstatohet se në datën 7.11.2011 bashkëshortja e subjektit, znj. A.Ll., ka blerë këtë mjet në vlerën 2,800 euro dhe se në datën 30.5.2017 e ka shitur⁹¹ për vlerën 1,200 euro⁹².

69.3. Mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie: bazuar në pikën 14 të nenit 3 si edhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. E.Ll., dhe z. Sh.Nd., bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast, bazuar në parimin e proporcionalitetit të shumave 1,800 euro dhe 1,000 euro të dhuruara në favor të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

69.4. Rezulton se me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentin “nxjerrje llogarie” nga “Raiffeisen Bank” të datës 13.10.2016⁹³, sipas të cilit konstatohet se në datën 1.7.2011, vëllai i bashkëshortes, z. E.Ll., ka transferuar në favor të babait të tij, z. P.Ll., shumën 8,287 euro.

69.5. I pyetur nga Komisioni⁹⁴ për burimin e të ardhurave të dhuruara nga personat e tjerë të lidhur për blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se *vëllai i bashkëshortes, z. E.Ll., prej vitesh punon në Itali. Ndërsa, për vëllain e tij, z. Sh.N., deklaroi se në vitin 2011 ka qenë administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., dhe se sipas tij të ardhurat nga pagat i ka patur në shumën 90,000 lekë në muaj si edhe shoqëria ka shpërndarë dividend për vitin 2010.*

69.6. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka referuar se ka vënë/do vihen në dispozicion dokumentacion për të ardhurat e vëllait të bashkëshortes së tij, z. E.Ll., si: (i) kopje të kontratës së punës të datës 10.10.2009; dhe (ii) dokumentacion për të ardhurat për atë periudhë, CUD 2011, por rezultoi se ky dokumentacion nuk është dërguar nga subjekti në Komision.

69.7. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. E.Ll.

⁸⁹ Kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2011.

⁹⁰ Shkresa me nr. ***prot., datë 9.8.2019.

⁹¹ Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.5.2017.

⁹² Deklaruar shitja e këtij automjeti në DPV/2017.

⁹³ Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹⁴ Pyetësori nr. 2.

69.8. Me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit depozitoi dokumentacion justifikues ligjor për të ardhura të përfituara nga z. E.Ll., nga puna e tij në shtetin italian⁹⁵, nga verifikimi i të cilit, Komisioni konstaton se personi tjetër i lidhur ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht dhurimin e shumës 1,800 euro në favor të bashkëshortes së subjektit.

69.9. Ndërsa lidhur me të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. Sh.N., DRSSH-ja Lezhë për vitin 2011 referon të dhëna për të ardhurat nga pagat e këtij shtetasi si vijon: (i) për periudhën janar 2011 – korrik 2011 paga mbi të cilën i janë paguar kontributet është në vlerën 35,000 lekë; dhe (ii) për periudhën gusht 2011 – tetor 2011 paga mbi të cilën i janë paguar kontributet është në vlerën 87,700 lekë. Gjithashtu, rezulton se z. Sh.N., në vitin 2011 ka shitur aksionet që zotëronte në shoqërinë “****” sh.p.k., në vlerën 51,000 lekë.

70. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se z. Sh.N., në cilësinë e personit tjetër të lidhur ka patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të dhuruar shumën 1,000 euro në favor të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

70.1. Si konkluzion, Komisioni konstaton se subjekti/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie dhe se nuk ka dyshime për krijimin e saj, për sa kohë u provua se personat e tjerë të lidhur kanë patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e dhurimeve në favor të personit të lidhur, deklaruar si burim krijimi i kësaj pasurie.

71. TË TJERA

71.1. Shpenzimet shëndetësore të bashkëshortes së subjektit

71.2. Referuar DPV/2016 konstatohet se në rubrikën “shpenzime të deklarueshme”, subjekti ka deklaruar shpenzime shëndetësore për ndërhyrje kirurgjikale të bashkëshortes së tij në spitalin “****”, Bolonja, Itali, shumën 10,700 euro.

71.3. Ndërsa, në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar: (i) shumën 4,000 euro të dhuruar nga P.Ll., (babai i bashkëshortes) dhe D.B., (e motra e bashkëshortes); si edhe (ii) shumën 7,000 euro, të dhuruar nga vëllezërit e tij, z. P.N., dhe z. Sh.N., për ndërhyrjen kirurgjikale të bashkëshortes. Për kryerjen e këtyre dhurimeve, palët kanë nëshkruar deklarata noteriale të datës 28.1.2016⁹⁶.

71.4. Në bazë të pikës 14 të nenit 3 si edhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. P.Ll., znj. D.B., z. P.N., dhe z. Sh.N., bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast bazuar në parimin e proporcionalitetit, të shumave të dhuruara – të referuara si më sipër.

71.5. Gjithashtu, referuar DPV/2017 dhe përgjigjeve të pyetësorit nr.1, subjekti ka deklaruar huan nga të tretë (hua e dhënë nga znj. O.N.) me afat të pacaktuar dhe pa interes në shumën 300,000 lekë, transferuar në llogarinë e bashkëshortes në datën 20.12.2017 (me kontratë të nënshkruar nga palët - jo noteriale), si edhe huan në shumën 2,000,000 lekë të marrë vëllait, z. Sh.N., formalizuar me kontratën noteriale⁹⁷ të datës 6.2.2017.

⁹⁵ Ekstrakt i llogarisë së sigurimit regjimi i përgjithshëm, lëshuar më 17.2.2020 për E.Ll., nga INPS Itali (Apostille) e përkthyer dhe e noterizuar.

⁹⁶ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.1.2016 dhe deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.1.2016.

⁹⁷ Kontrata me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.2.2017.

71.6. Në bazë të pikës 14 të nenit 3 si edhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, znj. O. N., dhe z. Sh.N., bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast, bazuar në parimin e proporcionalitetit, të të ardhurave që kanë shërbyer për shumat e dhënë hua në favor të bashkëshortes së subjektit – të referuara si më sipër.

Analiza ligjore/financiare për burimin e shumave të dhuruara dhe të dhëna hua

72. Nga përgjigjet e pyetësorit nr. 1⁹⁸ konstatohet se subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka specifikuar kontributin e secilit dhurues, e konkretisht ka deklaruar se z. P.Ll., dhe znj. D. B., kanë dhuruar nga 2,000 euro secili dhe z. P.Nd., dhe z. Sh.N., kanë dhuruar nga 3,500 euro secili.

72.1. I pyetur nga Komisioni mbi mënyrën e dhënies së këtyre shumave dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimit të tyre nga palët dhuruese⁹⁹, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se *vlerat monetare i janë dhënë cash dhe se: (i) babai i bashkëshortes, z. P. Ll., i ka deklaruar se burimi i vlerave monetare të dhuruara janë kursmjet nga aktiviteti i tregtar i bashkëshortes së tij, znj. M.Ll.; (ii) motra e bashkëshortes, znj. D.B., ka deklaruar se ajo ka qenë rezidente në shtetin italian dhe ka krijuar të ardhura nga puna ndër vite; (iii) ndërsa vëllezërit i kanë deklaruar se burimin i të ardhurave janë të ardhurat personale, pagat që kanë marrë dhe aktiviteti ekonomik i shoqërisë “***” sh.p.k.*

72.2. Për të dokumentuar ligjshmërinë e të ardhurave të palëve dhuruese, ndër të tjera, subjekti ka depozituar dokumentacionin fotokopje si vijon: (i) kontratë shitblerjeje toke me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.3.2001; (ii) vërtetim nga DRT-ja Lezhë nr. *** prot., datë 14.11.2015, (iii) formularin e deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin i subjektit “***” me Nipt ***; (iv) dokumentin, lejeqëndrimi në shtetin italian të znj. D.B.; dhe (v) listëpagesë të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për subjektin “***” sh.p.k.

72.3. Lidhur me të ardhurat e dhuruara nga babai i bashkëshortes në vitin 2016, subjekti ka dorëzuar kontratë shitblerjeje toke të vitit 2001, sipas së cilës z. P.Ll., ka shitur pasurinë e llojit “tokë arë” me sipërfaqe 4,592 m² të ndodhur në Fushë - Mamurras, për vlerën 900,000 lekë. Gjithashtu, QKB-ja¹⁰⁰ konfirmon se M.Ll., figuron e regjistruar si person fizik me Nipt ***. DRT-ja Lezhë¹⁰¹ konfirmon se ky subjekt tregtar ka realizuar fitim për vitin 2015 shumën 49,856 lekë dhe për vitin 2016 shumën 368,410 lekë. ISSH-ja¹⁰², konfirmon se znj. M.Ll., prej shtatorit 2015 e në vijim deklaron pagë bruto mbi të cilën paguan kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shumën 22,000 lekë.

72.4. Nga analiza e të dhënave të mësipërme Komisioni vlerëson se prindërit e bashkëshortes së subjektit kanë patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shumën e dhuruar në vitin 2016 (deklaruar si e dhuruar nga babai i bashkëshortes).

72.5. Lidhur me të ardhurat e dhuruara nga motra e bashkëshortes në vitin 2016, subjekti ka deklaruar se ajo ka përfituar të ardhura nga punësimi në shtetin italian, por nuk ka depozituar dokumentacion ligjor provues.

72.6. Bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit duke i kërkuar të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e personit tjetër të lidhur,

⁹⁸ Pyetja nr. 2 – përgjigje nr. 2 / pyetësori nr. 1.

⁹⁹ Pyetja nr. 13 - përgjigje nr. 13/ pyetësori nr. 2.

¹⁰⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 27.8.2019.

¹⁰¹ Shkresa nr. *** prot., datë 22.8.2017, administruar në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰² Shkresa nr. *** prot., datë 5.8.2019.

znj. D.B., të cilat kanë shërber si burim për dhurimin e shumës 1,800 euro në favor të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit.

72.7. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se znj. D.B., (kunata e tij) prej vitesh ka jetuar dhe punuar në shtetin italian si emigrante ekonomike me leje qëndrimi të rregullt, së bashku me bashkëshortin e saj. Lidhur me punësimin e saj në shtetin italian ajo i ka deklaruar¹⁰³ se ka jetuar dhe punuar në shtetin italian si *badante* (në shërbim të personave të moshës së tretë - e pasiguruar). Gjithashtu, bashkëshorti i saj ka punuar dhe jetuar prej vitesh në shtetin italian.

72.8. Në mbështetje të deklarimeve të tij, krahas deklaratës noteriale të shtetases D.B., subjekti i rivlerësimit ka depozituar si prova: (i) lejet e qëndrimit për të huaj në shtetin italian, për D., dhe Sh.B.; dhe (ii) dokumentacion për të ardhurat e biznesit në shtetin italian për shtetasin Sh. B., nga ku duket se vetëm për vitin 2015 të ardhurat bruto të tij janë në shumën 84,000 euro.

72.9. Sa më sipër, duke vlerësuar shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë marrëdhënie dhurimi, si edhe duke marrë në konsideratë qëllimin e dhurimit, Komisioni vlerëson se familja B., ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shumën e dhuruar nga znj. D.B., në favor të motrës së saj (bashkëshortes së subjektit) në vitin 2016.

73. Lidhur me shumat e dhuruara apo të dhëna hua nga vëllezërit e subjektit, nisur nga fakti se të ardhurat e tyre janë përfshirë edhe më parë si burime në krijimin e pasurive të tjera të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (referohu pasurisë së llojit “apartment” dhe pasurisë së llojit “automjet” në emër të bashkëshortes), Komisioni pasqyroj të ardhurat e tyre nga paga, të papërfshira në analizat e pasurive të mësipërme, të cilat bazuar në informacionin e përcjellë nga ISSH-ja¹⁰⁴ dhe DRSSH-ja Lezhë¹⁰⁵, pasqyrohen si më poshtë:

	P.N.	Sh.N.
Viti/periudha	Paga bruto (lek)	Paga bruto (lek)
nëntor – dhjetor 2011		175,400
qershor – dhjetor 2012	182,000	
2012		1,080,000
2013	268,000	1,080,000
2014	242,000	990,000
2015	264,000	840,000
2016	352,000	840,000
janar 2017	30,000	70,000
Totali	1,338,000	5,075,400

73.1. Gjithashtu, DRT-ja Lezhë¹⁰⁶ konfirmon se shoqëria “****” sh.p.k., për periudhën tatimore viti 2016 ka shpërndarë dividend në shumën 5,000,000 lekë.

73.2. Nga analiza e të dhënave të mësipërme Komisioni vlerëson se vëllezërit e subjektit të rivlerësimit kanë patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shumat e dhuruara apo të dhëna hua në vitin 2016 dhe 2017, të pasqyruara si më sipër.

¹⁰³ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2020.

¹⁰⁴ Shkresa nr. nr. ***prot., datë 27.7.2017.

¹⁰⁵ Shkresa nr. ***prot., datë 30.10.2019.

¹⁰⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 2.8.2019.

74. Lidhur me të ardhurat e dhëna hua nga znj. O.N., subjekti ka deklaruar shumën e dhënë në DPV/2017, si edhe ka dokumentuar mënyrën e kalimit të kësaj shume (me transfertë bankare), por nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e përfituara nga kjo shtetase që kanë shërbyer si burim për dhënien e huas.

74.1. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit.

Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit lidhur me këtë mardhënie huaje subjekti ka depozituar si prova të reja dokumentacionin si vijon: (i) kontratë huaje e datës 20.12.2017 (shkresë e thjeshtë); si edhe (ii) vërtetim¹⁰⁷ për të ardhurat neto nga paga për vitin 2017, për personin tjetër të lidhur, shtetasen O.N.

74.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, Komisioni konstaton se personi tjetër i lidhur, znj. O.N., ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht dhënien e huas në shumën 300,000 lekë në favor të bashkëshortes së subjektit.

75. Pasuri e llojit “automjet”, e markës “Audi”, tip “A6”, (krijuar pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”), blerë në datën 17.6.2017, në shumën 1,200 euro dhe për të cilën janë kryer shpenzime zhdoganimi në vlerën 73,025 lekë.

75.1. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit të markës “Smart”, tip “Micro”, në datën 30.5.2017, në shumën 1,200 euro; dhe (ii) mbulimin e shpenzimeve të zhdoganimit me të ardhurat nga pagat.

75.2. DPSHTRR-ja¹⁰⁸, konfirmon regjistrimin e këtij automjeti në emrin e subjektit të rivlerësimit dhe gjithashtu konfirmohet çmimi i deklaruar për blerjen e kësaj pasurie.

75.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie në DPV/2017 dhe se nuk ka dyshime për krijimin e saj.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

76. Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kryer në datën 29.5.2012 për kalimin e të drejtave mbi apartamentin e ndodhur në Tiranë; (ii) duket se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me rregullat etikës, pasi me veprime aktive ka marrë pjesë në nëshkrimin e një kontrate në mungesë të njëjës palë dhe shfaqjes së ligjshme të vullnetit të saj, kontratë e cila është paraqitur në institucionet publike, dhe se ngrihen dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tërësisë së kësaj marrëdhënie juridike – për kalimin e të drejtave pasurore mbi apartamentin në Tiranë.

76.2. Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (1) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara; dhe (2) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

¹⁰⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë 11.2.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁰⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 9.8.2019.

B. KONTROLLI I FIGURËS

77. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

77.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar në Komision raportin¹⁰⁹ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Bib Ndreca, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjta gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

77.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese, të kryera në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit¹¹⁰.

77.3. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

78. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Bib Ndreca, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor¹¹¹

79. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

79.1. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera, që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

79.2. Të dhëna nga burimet arkivore: sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezultojnë se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për gjyqtarin Bib Ndreca është paraqitur 1 ankesë në Inspektoratin e KLD-së, në vitin 2016. Kjo ankesë për

¹⁰⁹ Raportin me nr. *** prot., datë 30.10.2017

¹¹⁰ Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 7.7.2020.

¹¹¹ Raporti nr. *** prot., datë 12.2.2019.

mosrespektim formal të ligjit është verifikuar dhe është arkivuar, pasi pretendimet kanë qenë të pabazuara.

79.3. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Bib Ndreca përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

79.4. Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se në përgjithësi identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së çështjes gjyqësore, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit si edhe shfaq aftësi në arsyetimin ligjor.

79.5. Për gjyqtarin Bib Ndreca konstatohet se ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë, si dhe bën përpjekje për përfundimin në kohë të gjykimeve, që është tregues i lidhur me aftësinë për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim.

79.6. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet/dokumentet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjithashtu, nuk rezultojnë raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

80. Hetimi i Komisionit për këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

80.1. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

80.2. Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja si organi ndihmës për vlerësimin profesional, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

80.3. Në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, z. Bib Ndreca, u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 7 denoncime të depozituara nga publiku në Komision, për të cilat subjektit iu kërkuar të japë shpjegime. Subjekti dërgoi prapësimet e shoqëruara me shpjegimet përkatëse. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse mbi pretendimet e ngritura në denoncimet e publikut, ku, nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana, që mund të ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

81. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

81.1. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

IV. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

- a. subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bib Ndreca, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 18.1.2021

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila Pine
Kryesuese

Pamela Qirko
Relatore

Etleđa Çiftja
Anëtare

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore